



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë  
Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”  
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë  
“Akademia Ivodent”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:



1. Prof. Ramazan Isufi

2. Prof. Merita Bardhoshi

Mars 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Ivodent”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Akademia Ivodent
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Protetikës, Fakulteti i Teknikave Dentare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 371, dt. 23.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike, 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	13 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021, 22 studentë 2021-2022, 36 studentë 2022-2023, 64 studentë Totali 120 studentë.
19	Komente / të tjera:	-

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Akademia Ivodent është institucion jopublik i arsimit të lartë, i krijuar në bazë të ligjit 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" i riorganizuar nga Kolegji "Ivoclar Vivadent & Partners", i cili është licensuar me Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 19.02.2009 dhe akredituar në vitin 2013 nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), sot Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), proces i finalizuar me Vendimin të Këshillit të Akreditimit (KA), sot Bordi Akreditimi dhe Akredituar me kohëzgjatje 6 vjecare me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës (MASH), Nr. 328, datë 15.08.2013 (sot Ministria e Arsimit dhe Sportit, MAS).

Programi i studimit BSc në Teknikë e Lartë Dentare (TLD), ofrohet nga Departamenti i Protetikës. Ky program është licensuar me të njëjtin vendim të Këshillit të Ministrave dhe është akredituar me afat 6 vjeçar nga APAAL në vitin 2013 me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 328, datë 15.08.2013. Më vonë programi TLD është riakredituar me Vendimin nr. 20 datë 24.01.2020 deri në shtator 2022. Në vitin 2021 programi TLD është riorganizuar me Vendimin e Senatit të Akademisë Ivodent (AI) nr. 63, datë 02.12.2020 dhe me Urdhër nr. 371, datë 23.09.2021 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit. Riorganizimi është kryer bazuar edhe në rekomandimet e dhëna në Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 20 datë 24.01.2020. Meqenëse riorganizimi sipas këtij Urdhëri është kryer në masën mbi 20%, akreditimi i programit TLD kryhet si proces i akreditimit për herë të parë.

Programi synon të japë njohuri që lidhen me përgatitjen e aparateve ortodontike dhe protezave të ndryshme dentare, të ndara në proteza fikse, proteza të lëvizshme dhe proteza të kombinuara. Protezat fikse janë ato prej metali, metal-qeramike, qeramike të presuar, suprastruktura mbi implante dhe prej materialesh kompozite. Ndërsa si proteza të lëvizshme gjatë studimit përgatiten proteza totale, e pjeshme e thjeshtë, e pjeshme e skeletuar, proteza mbi kurora teleskopike dhe me atashmente. Programi aftëson teknikët dentarë që të jenë të gatshëm të sigurojnë protezim dentar cilësor në laboratorin dentar në çdo rast diagnoze të vendosur nga mjeku stomatolog.

Për të arritur këto objektiva programi është konceptuar dhe organizuar me gërshetimin e njohurive teorike thelbësore me praktikën laboratorike.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga ekspertët e caktuar nga ASCAL, Prof. Ramazan Isufi, Prof. Merita Bardhoshi dhe përfaqësja e ASCAL, Znj. Endra Velaj.

Ekspertet kishin në dispozicionin e tyre për vlerësim Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe një numër të konsiderueshëm dokumentash. Grupi i vlerësimit u njoh dhe konsultoi fillimisht dokumentat e dorëzuara nga AI për akreditimin dhe zhvilloi vizitën në Akademinë Ivodent në datat 25 dhe 26 Janar 2023.

Axhenda e takimeve ishte konceptuar gjithëpërfshirëse. Gjatë këtyre ditëve u zhvilluan takime me përfaqësues të këtij institucioni, drejtuesit e Fakultetit të Teknikave Dentare, Departamentit, grupin e punës së vlerësimit të brendshëm dhe personelin e programit për të kuptuar dhe pyetur më tej në lidhje me vlerësimin e brendshëm dhe realizimin e programit të studimit.

I gjithë personeli dhe stafi akademik treguan disponibilitet dhe korrektesë gjatë procesit të akreditimit.

Takimet u zhvilluan dhe me studentët e programit të studimit, si dhe zyrat administrative të Sekretarisë Mësimore e Mbështetjes ndaj Studentit, Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Komisionit të Mbështetjes së Kërkim Zhvillimit, Bibliotekës dhe Shërbimeve IT, si edhe vizitë në ambientet e laboratorëve praktike, auditorëve, bibliotekës etj.

Si përfundim, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është konsultuar për gjetjet dhe konkluzionet në këtë raport dhe kanë rënë dakord për vlerësimin e standardeve sipas kriterëve përkatëse.

**Me datë 06/03/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 12/2 Prot., Datë 06/03/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 926 Prot., Datë 08/03/2023. Institucioni vlerëson punën e GVJ dhe shprehet se nuk ka komente lidhur me Draft-Raportin e këtij programi studimi. Në këtë mënyre, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm merr formën e tij finale e përfundimtare.**

# Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b> <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”, i ofruar nga Departamenti i Protetikës së Akademisë Ivodent nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me misionin e AI, i cili synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe përgatitjen e specialistëve në fushën e teknikave dentare analoge dhe digjitale, në përputhje me standartet Europiane. Institucioni, në mbështetje të mëtejshme të zhvillimit akademik të studentëve, ka hapur Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare”, në vitin akademik 2021-2022 dhe është në fazë aplikimi për hapjen e një Masteri Shkencor në “Teknika Dentare Laboratori e Klinike” në përputhje me zhvillimet në fushën e dentistrisë, të profesionit të teknikut dentar dhe kërkesave e nevojave të tregut në vendin tonë dhe më gjerë.  <i>[Ref. Statuti i Akademisë Ivodent, A.1, Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI (2018-2023), Politika e zhvillimit strategjik të programeve AI, Dosja e Programit TLD, Takimi me drejtuesit e AI]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga vlerësimi i GVJ, mund të konfirmojmë se programi i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe Statutit të AI, në të cilin theksohet se misioni i institucionit është “ofrimi i programeve të studimit me karakter profesional në fushën e shëndetit dentar dhe teknikave e shkencës së materialeve të lidhura me të”. Vlen të përmendet edhe raporti teori-praktikë, në favor të praktikës së zhvilluar brenda ambienteve të institucionit dhe në laboratorë dentare, në formën e praktikave profesionale.  <i>[Ref. Statuti i Akademisë Ivodent, Dosja e Programit TLD, Politika e zhvillimit strategjik të programeve AI]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit është në përputhje me Statutin, Rregulloren e AI dhe Strategjinë për Zhvillim (2018-2023). Institucioni ka eksperiencë pothuajse 20 vjeçare në fushën e edukimit të teknikave dentare duke u kujdesur që të përgatisë studentë të aftë dhe që njohin teknika, materiale, aparatura e instrumente bashkëkohore, përmes infrastrukturës apo trajnimeve të vazhdueshme. Studentët e programit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” aftësohen në prodhimin e protezave dentare e aparateve ortodontikë, prodhimin e protezave të kombinuara me atashmente dhe teleskopë, faseta prej qeramike Emax, konform fushës së aktivitetit akademik të institucionit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al



Web site: www.ascal.al

	<p>[Ref. Statuti i Akademisë, Strategjia e Zhvillimit të Institucionit AI (2018-2023), Dosja e Programit TLD, Plani mesimor TLD]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar rezultoi se AI ka qenë ndër institucionet e para në Shqipëri që institucionalizoi profesionin e teknikut dentar, i cili që në fillimin e tij ka ofruar vetëm programin Bachelor TLD, në vitin 2010, i cili ka kaluar përmes procesesh akreditimi e kontrollesh të vazhdueshme nga MAS, vlerësojmë se institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme dhe të duhura në funksion të programit.</p> <p>Në mbështetje të mbarëvajtjes së programit mesimor, angazhohen krahas anëtarëve të Departamentit të Protetikës, edhe anëtarë të Departamentit të Ortodontisë dhe Qendrës së Studimit të Teknikave, si dhe staf akademik nga universitete të tjera me të cilat AI ka marrëveshje. AI, duke qenë institucion relativisht i vogël, ka marrëveshje me MAS për numër të reduktuar të personelit akademik të brendshëm. Për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik dhe ndihmës përkushtuar programit Bachelor TLD është:</p> <p>PAE: 2-Prof. Dr, 4-Dr., 7-MSc, PAK: 1-Prof. Dr., 3-Dr., dhe 5 staf ndihmës akademik me eksperiencë dhe të mirëtrajnuar në punime dentare.</p> <p>Nga vizita në institucion, u vërejt që institucioni ofron infrastrukurën e nevojshme logjistike dhe veçanërisht atë didaktike për zhvillimin e programit Bachelor TLD, siç janë sallat e leksioneve, seminareve, laboratorët e pajisur me aparatura bashkëkohore dhe bibliotekën fizike. AI ka punuar për plotësimin e bibliotekës fizike dhe librarive online, me literaturë specifike për profesionin e teknikut dentar dhe shëndetit oral në përgjithësi, në vazhdimësi të plotësimit të rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në akreditimin e fundit institucional. Në shërbim të infrastrukurës vjen edhe bashkëpunimi i AI me kompanitë Ivoclar-Vivadent AG (Lihtenshtein), BEGO GmbH (Gjermani), Rhein 83 (Itali), Renfert GmbH (Gjermani) etj., nëpërmjet marrëveshjes me përfaqësuesin e tyre për Shqipërinë “Dorina Mele Co. shpk”, dhe qendrat e edukimit dentar pranë tyre si psh: Ivoclar Academy për të cilën Akademia Ivodent është edhe partner zyrtar për Shqipërinë. Këto kompani mundësojnë trajnime të përvitshme për studentët e AI, duke sjellë për ta të reja më të fundit nga Departamentet e tyre të Kërkim Zhvillimit. Gjithashtu, ato i vënë në dispozicion Akademisë aparaturat e materialet e sapokrijuara prej tyre, duke ju krijuar kështu studentëve avantazhin e të qenit konkurrues me produktet më të reja të tregut dentar. Ato japin një kontribut të vecantë edhe në mësimdhënie përmes materialeve didaktike dhe trajnimeve të vazhdueshme për stafin dhe studentët e alumni të AI.</p> <p>[Raport Infrastruktura 2022, Marrëveshje Ivodent DMCO, Verifikim i kapaciteteve - MAS 22-23, Tabela permbledhese TLD]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë</p>	<p>GVI vëren se programi i studimit, i ofruar nga Departamenti i Protetikës, Fakulteti i Teknikave Dentare është në përputhje të plotë me fushën e përgjithshme dhe specifike të njësisë bazë dhe kryesore, e cila përfshin arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e teknikave dentare dhe materialeve dentare.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Niveli i kualifikimit është 6 sipas KSHK.		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konkludon se programi i studimit i ofruar nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me misionin, Statutin dhe aktet rregullatore të Akademisë Ivodent. Institucioni ka përvojë 20 vjeçare në fushën e edukimit të teknikave dentare, staf të kualifikuar përmes moduleve e trajnimeve të avancuara e në vazhdimësi nga trajnues të partnerëve evropianë të AI mbi punimet protetike, materialet, teknikat e aparaturat e teknologjisë së zhvilluar. Krahas stafit të mirëpërgatitur, AI në shërbim të programit dhe studentëve ka vënë infrastrukturën bashkëkohore dhe ka punuar për përmirësimin e bibliotekës fizike dhe asaj online, sipas rekomandimeve të Bordit të Akreditimit. Programi Bachelor TLD i përket nivelit të kualifikimit 6 sipas KSHK.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</p>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.**



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>AI ushtron aktivitetin e tij në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, konfirmuar nga kontrollet e vazhdueshme të MAS dhe procedurat e akreditimit institucional dhe të programeve që institucioni ofron. Dokumentat rregullatore, si Statuti dhe Rregulloret përcaktojnë dhe sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë, të cilat pasohen nga analiza dhe vlerësimi i vazhdueshëm, si dhe sistemin e karrierës bazuar mbi meritat.</p> <p>Si shembull i bashkëpunimit brenda institucionit shërben procedura e ndjekur për riorganizimin e programit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”, nisur nga rekomandimet e akreditimit të programit në 2020. Kjo procedurë fillon në departament dhe përfundon me miratimin në Senat dhe Bordin e Administrimit të AI.</p> <p>[Ref. RVB, takim me stafin e programit]</p> <p>Mbarëvajtja e programit sigurohet edhe nëpërmjet anketimeve nga NJSBC, rezultatet e të cilave diskutohen në analizën e punës në Departament dhe merren masat e nevojshme përmirësuese.</p> <p>[Ref. Urdhër i akreditimit të parë institucional dhe programit, Rregullore Fakulteti Ivodent, Rregullore Departamenti, Raport NJSBC mbi Anketat, PSV Mbledhje personeli akademik për diskutimin e analizës së cilësisë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>dhe aplikimit për programin e ri Master Shkencor, Propozim për riorganizimin e programit TLD, Vendim Senati për riorganizimin e Programit TLD, Vendim Bordi Administrimi për riorganizimin e TLD, Urdher MAS për riorganizimin e Bachelor TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Nga biseda me drejtuesit e AI dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vëren që institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë vendas dhe ndërkombëtar. Në kuadër të këtyre marrëveshjeve realizohet shkëmbim stafi, trajnime, praktika profesionale etj.</p> <p><i>[Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale, Marrëveshja Ivodent-FMD UMT, Marrëveshje Ivodent - AU, Marrëveshje Ivodent - UPT, Marrëveshje Ivodent - Universiteti i Pancevo, Marrëveshje Ivodent - CIT]</i></p> <p>Në ndihmë të programit dhe studentëve institucioni ka marrëveshje edhe me qendra të mëdha dentare në vend si AT Group dhe DCA me qëllim trajnimin profesional të studentëve dhe kryerjen e praktikave profesionale të parashikuara në program. Vlen për tu përmendur edhe aktiviteti me Ivoclar Academy dhe partnerët gjermanë, i cili ka dhënë rezultate në formimin e studentëve dhe përbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p><i>[Ref. Marrëveshje Ivodent-AT Group dhe DCA Albania, Kontratë për kryerjen e praktikës profesionale (Biosa)]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për shkak të karakterit profesional të programit dhe të institucionit në tërësi, AI ka marrëveshje edhe me institucione, kompani të fushës së teknikave dentare për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj. Ky bashkëpunim lind për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale të parashikuar për studentët në vitin e dytë dhe të tretë, u shërben studentëve të kenë mundësi të marrin pjesë në organizimin e konferencave të ndryshme apo në programet e mobilitetit.</p> <p><i>[Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale, Marrëveshje Ivodent-AT Group dhe DCA Albania, Marrëveshje Ivodent DMCO, Marrëveshje Ivodent BBW Gjermani]</i></p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimi me Zyrën e Karrierës, në vitet e fundit, studentët e vitit të tretë mund të zgjedhin të kryejnë praktikën profesionale në 2 laboratorë dentarë në Gjermani, falë marrëdhënies që Akademia Ivodent ka vendosur me këto laboratorë. Përfaqësues të Bordit të Administrimit dhe të Zyrës së Karrierës planifikojnë zgjerimin e marrëdhënieve edhe me laboratorë të tjerë gjermanë përgjatë vitit 2023. Për studentët të cilët zgjedhin të vazhdojnë të punojnë në Gjermani, njohja e diplomës realizohet me sukses, siç kuptohet edhe nga marrëveshja që Akademia ka me BBW.</p> <p><i>[Ref. takim me Zyrën e Karrierës, Marrëveshje Ivodent BBW Gjermani]</i></p>




	<p>AI është në negociata për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Universitetin e Shtip-it (Republika e Maqedonisë së Veriut) dhe ka aplikuar për Erasmus + me Universitetin Politeknik të Gdansk-ut (Poloni) të cilat janë nga të paktat universitete europiane që ofrojnë studime universitare për teknikë dentare dhe mundësojnë mobilitete të personelit akademik dhe studentëve në kuadrin e Erasmus+.</p> <p>[Ref. Aplikim Erasmus+ me TUGdansk]</p> <p>Ndërkohë aktualisht institucioni ka nënshkruar rreth 15 marrëveshje me klinika/ laboratorë dentarë brenda vendit për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë bisedës me stafin drejtues dhe akademik përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”, u eventua që hartohet raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet nga një grup pune i caktuar nga përgjegjësi i Departamentit të Protetikës. Ky raport, pjesë e dokumentacionit të përbashkët të dorëzuar nga AI, diskutohet më pas në departament. Ai bëhet pjesë e raportit vjetor që institucioni dorëzon pranë MAS për çdo vit akademik.</p> <p>[Ref. Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale, PSV Mbledhje Personeli akademik për miratim analizë përfitimi nga marrëveshjet, Raporti vjetor 2021-2022]</p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Në mbështetje të dokumentacionit dhe takimeve të zhvilluara, GVJ konkludon se aktet rregullatore të AI sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi në institucion, përmes ndarjes së detyrave dhe përgjegjësive, të cilat pasohen nga analiza dhe vlerësimi i vazhdueshëm. Për mbarëvajtjen e programit të studimit, krahas Departamentit të Protetikës, përgjegjës për programin e studimit, kontribuojnë edhe stafi akademik i Departamentit të Ortodoncisë dhe Qendrës së Studimit të Teknikave. Krahas stafit të AI, institucioni ka marrëveshje edhe me qendra të mëdha dentare në vend si AT Group dhe DCA me qëllim trajnimin profesional të studentëve dhe kryerjen e praktikave profesionale të parashikuara në program. Partneriteti shtrihet edhe në Gjermani dhe me Ivoclar Academy për trajnime, zhvillimin e praktikave profesionale etj. Në përfundim të vitit akademik hartohet një raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet nga një grup pune i caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit. Ky raport bëhet pjesë e raportit vjetor që i dërgohet më pas MAS.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës I	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënljgore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit vlerëson se kurríkula e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” është e organizuar me lëndë të vlerësuara me kredite përkatëse, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS). Referuar planit mësimor të programit të studimit Bachelor TLD, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në lëndë dhe module të specifikuar në 5 kategori nga A-E, në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Programi i studimit zgjat 3 vite akademike, me 180 ECTS. GVJ konstatoi se në planin mësimor paraqiten qartë lëndët, ndarja në leksione, seminare, laboratore, detyrë/projekt, orët e praktikës sipas semestrave dhe viteve akademike, si edhe provimi përfundimtar, shoqëruar me kreditet përkatëse (ku 1 krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore dhe pune të studentit).</p> <p style="text-align: center;"><i>[Ref. Plani mesimor TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Kurríkula e programit të studimit është ndërtuar në përputhje me Nivelin 6 të KSHK dhe synon aftësimin e studentëve në fushën e teknikave dentare që përdoren për përgatitjen e protezave dentare dhe aparateve ortodontikë në laboratorin dentar. Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve, GVJ vëren se studentët pajisen me njohuri të ndryshme në menaxhim të laboratorit dentar, etikë profesionale, deontologjia sociale, metodika shkencore, gjuha angleze e deri tek pjesa më e rëndësishme e teorisë dhe praktikës së protezimit dentar.</p> <p style="text-align: center;"><i>[Ref. Plani mesimor TLD]</i></p> <p>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor TLD është strukturuar në mënyrë të tillë që të garantojë arritjen e objektivave, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushave të veprimit të teknikave dentare, me gërshetimin praktik të tyre. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave dhe punimit përfundimtar, synohet që t’ju jepen studentëve njohuri të përparuar akademike dhe shprehi praktike në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare, si dhe të zhvillohet i kuptuari kritik i koncepteve që jepen në teori nëpërmjet aplikimit praktik të tyre në laboratorin dentar. Shpërndarja e orëve është në favor të praktikës në mënyrë që të garantohet zgjidhja e problemeve që lidhen me nivelin, profilin e programit dhe natyrën e punës që parashikohet të kryejë tekniku dentar.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Analiza e të dhënave mbi lëndët, ngarkesat përkatëse në kredite dhe kategoritë e përcaktuara në kurrikulën e programit tregon se ato janë gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Ky program përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41, datë 24.01.2018 të ndryshuar. Lëndët e programit të studimit janë të organizuara në kategori disiplinash dhe me kreditet përkatëse. Studentët që përfundojnë studimet në Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” diplomohen me 180 ECTS. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksionesh, seminare, detyra/ projekte dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit. Programi përmban 25 lëndë, prej të cilave 7 të kategorisë A (34 kredite ECTS), 7 të kategorisë B (103 kredite ECTS), 7 të kategorisë C (25 kredite ECTS), 4 të kategorisë D (25 kredite ECTS) dhe 1 të kategorisë E (6 kredite ECTS). Ka dy lëndë me zgjedhje, dhe përmban praktikën profesionale e provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Ref. Plani mesimor TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor TLD parashikon kryerjen e dy praktikave profesionale në laboratorë ose klinika dentare, përkatësisht në vit të dytë dhe të tretë. Lëndët kanë sylabuset përkatëse me 8 dhe 13 kredite ECTS. Nga takimi me stafin akademik, i cili siguron mbarëvajtjen e praktikave profesionale dhe në takimin me studentë, dhe nga dokumentacioni shoqëruës i RVB, shikohet që për zhvillimin e praktikave profesionale AI nënshkruan fillimisht një marrëveshje me laboratorin/ klinikën dentare, në të cilin parashikohet dhe plani i punës që studenti duhet të ndjekë. Pedagogu përgjegjës për praktikën profesionale ka gradën dhe eksperiencën e gjatë në klinikë dhe laborator dentar, dhe në bashkëpunim me drejtuesin teknik të laboratorit, vlerësojnë me shkrim punimet e kryera nga studenti përmes plotësimit të dëshmisë javore.</p> <p><i>[Ref. takimi me stafin akademik, takim me studentët aktualë të programit, Plani mesimor TLD, Programi TLD, Udhezues për studentet i kryerjes së Praktikës Profesionale, Kontrate për kryerjen e praktikës profesionale TLD, Dëshmi javore e Praktikës Profesionale nga Laboratori]</i></p> <p>Provimi përfundimtar kryhet në laboratorët e institucionit, sipas afateve të përcaktuara në strukturë akademike dhe për të janë parashikuar 6 kredite. Provimi teston njohuritë teorike dhe praktike të një punimi që realizohet nga studenti në një periudhë 2 javore.</p> <p><i>[Ref. Dosja e Programit TLD, Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me</p>	<p>Akademia Ivodent nuk ka status të veçantë përse i përket financimit, organizimit apo funksionimit. Nisur nga përmasat e vogla të institucionit, AI ka nënshkruar marrëveshje me MAS për numër të reduktuar të stafit akademik në shërbim të institucionit dhe programeve që ai ofron.</p> <p><i>[Ref. Marrëveshja MASR - Ivodent]</i></p>

udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.									
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Akademia Ivodent ofron vetëm një program studimi Bachelor.								
<b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Sipas Udhëzimit të MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 për "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", AI po punon për kodifikimin e programeve që ofron.  [Ref. RVB]								
<b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Akademia Ivodent nuk ofron programe studimi të përbashkëta me IAL të tjera vendase ose të huaja.								
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ pas shqyrtimit të dosjes së programit, planit mësimor dhe sylabuseve të lëndëve të programit, arrin në përfundimin se Programi Bachelor në "Teknikë e Lartë Dentare" zgjat 3 vite akademike. Në planin mësimor paraqiten qartë lëndët, ndarja në leksione, seminare, laboratore, detyrë/projekt, orët e praktikës sipas semestrave dhe viteve akademike, si edhe provimi përfundimtar, shoqëruar me kreditet përkatëse. Programi përmban 25 lëndë, prej të cilave 7 të kategorisë A (34 kredite ECTS), 7 të kategorisë B (103 kredite ECTS), 7 të kategorisë C (25 kredite ECTS), 4 të kategorisë D (25 kredite ECTS) dhe 1 të kategorisë E (6 kredite ECTS). Ka 2 lëndë me zgjedhje, dhe përmban praktikën profesionale e provimin përfundimtar, një total prej 180 kreditesh. Programi i studimit ka të mirëpërcaktuar dhe dokumentuar realizimin e lëndëve të praktikës profesionale në 2 vite akademike dhe procedurën e zhvillimit të provimit përfundimtar. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën	Bazuar në organigramën e institucionit dhe nga takimet e zhvilluara me stafin drejtues dhe atë akademik e ndihmës akademik, GVJ vëren që institucioni është relativisht i vogël dhe sipas marrëveshjes së nënshkruar me MAS, është i zhveshur nga detyrimi ligjor për të patur 7 personel të

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>brendshëm efektiv për çdo njësi bazë, prej të cilëve të paktën 3 prej tyre janë me grada dhe tituj.</p> <p><i>[Ref. Marrëveshja MASR - Ivodent, Organigrama dhe Personeli 2022-2023, takim me drejtuesit dhe stafin akademik]</i></p> <p>AI përbëhet vetëm nga Fakulteti i Teknikave Dentare, i përbërë nga Departamenti i Protetikës, përgjegjës për programin Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”, Departamenti i Ortodoncisë dhe Qendra e Studimit të Teknikave. Departamenti i Protetikës ka 7 personel të brendshëm, një me titull Profesor, dy me gradë Doktor dhe 4 personel akademik me Master në Stomatologji, si edhe dy personel akademik të jashtëm me gradën Doktor e një Profesor i asociuar. Në mbështetje të programit të studimit vijnë edhe personeli akademik i Departamentit të Ortodoncisë dhe QST. Me rritjen e numrit të studentëve dhe me hapjen e dy programeve të reja, Burimet njerëzore të AI kanë rekrutuar staf në përmbushje të nevojave të krijuara.</p> <p><i>[Ref. takim me Burimet njerëzore, Verifikim i kapaciteteve - MAS 22-23]</i></p> <p>Institucioni është në pritje të vendimit të Bordit të Akreditimit mbi riakreditimin institucional ndërsa 3 programet e studimit që institucioni ofron i nënshtrohen për herë të parë procesit të akreditimit në periudhën 2022-2023.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislativën në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga takimet me stafin drejtues dhe stafin akademik dhe ndihmës-akademik, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vërejtë rëndësinë që institucioni i kushton personelit ndihmës-akademik në shërbim të programeve të studimit. Personeli ndihmës akademik ka kryer studime 2, 3 dhe 4 vjeçare në teknika dentare apo kanë edhe titull “Mjeshtër i Teknikës Dentare” (ZTM) nga shkolla e Mjeshtërisë për Teknikë Dentarë në Gjermani. Eksperiencia e tyre disave vjeçare në laboratorët dentarë dhe në mësimdhënie bëhet një aset i çmuar për programe me orientim profesional, si Bachelor TLD. Personeli ndihmës akademik ndihmon në realizimin e praktikave mësimore në klinikë dhe laboratorin dentar. Në planin për zhvillimin e karrierës së stafit të saj, personeli akademik dhe ai ndihmës trajnohen vazhdimisht nga bashkëpunëtorët e Akademisë, si 3Shape dhe Akademia Ivoclar.</p> <p><i>[Ref. Dokumentacion kualifikimi i personelit të ri ndihmës akademik 22-23, Plani për Zhvillimin e Karrierës për stafin dhe studentët Ivodent, takimi me drejtuesit, takimi me stafin]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Departamenti i Protetikës ka të përcaktuar koordinatorin e programit të studimit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatorin e programit, njëkohësisht edhe staf akademik që në fillimet e institucionit, ishte i pranishëm në mbledhjen me stafin akademik në ndihmë të programit, ku shpjegoi shkurtimisht detyrat që mbulonte.</p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, bazuar në organigramën e institucionit dhe nga takimet e zhvilluara me stafin drejtues dhe atë akademik e ndihmës akademik, konkludon se AI ka organizim të brendshëm, që përbëhet nga Fakulteti i Teknikave Dentare, 2 Departamente dhe 1 Qendër e Studimit të Teknikave. 3 njësitë bazë kontribuojnë në mbarëvajtjen mesimore të 3 programeve të studimit që ofron institucioni, për shkak të përmasave të vogla të tij. Stafi akademik, ndihmës dhe administrativ është i mjaftueshëm për të siguruar zhvillimin e programit Bachelor TLD. Institucioni ka të angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ të mirëpërgatitur dhe trajnuar, të cilët mbulojnë realizimin e praktikave mesimore në laboratorët e AI apo klinika dentare. Ai aplikon politika për planifikimin e zhvillimit të karrierës së stafit akademik, ndihmës dhe administrativ.</i></p> <p><i>Departamenti i Protetikës, përgjegjës për programin e studimit cakton koordinatoren nga personeli i tij akademik i cili ka detyra të përcaktuara në mbikqyrjen e mbarëvajtjes së programit.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</i></p>		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b> <b>X</b>

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>GVJ nga biseda me stafin akademik të Departamentit të Protetikës vlerëson se ai zotëron informacionet e duhura në lidhje me programin mesimor të Bachelor në "Teknikë e Lartë Dentare". Kjo u konfirmua edhe nga biseda me studentët dhe njësitë mbështetëse të AI. Të dhëna mbi programin e studimit, si Rregullorja e programit apo Plani mesimor, janë të aksesueshme për publikun në faqen e web <a href="http://www.ivodent.edu.al">www.ivodent.edu.al</a> dhe gjenden fizikisht në ambientet e sekretarisë dhe bibliotekës si Dosje e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. takim me stafin dhe njesite, Dosja e Programit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mesimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mesimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi Bachelor TLD është i detajuar në të dhënat që lidhen me planin mesimor, ngarkesën mesimore, orët, frekuentimin dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Nga shqyrtimi i planit mesimor dhe syllabuseve jepen informacione në lidhje me ngarkesën mesimore, orët në auditor dhe jashtë tij. Mënyra e vlerësimit të dijeve dhe kriteret e frekuentimit i gjejmë të specifikuar në syllabuset e lëndëve, rregulloren e programit dhe në tabelën 15, në tabelat përmbledhëse të përgatitura nga grupi i punës së RVB.</p> <p><i>[Ref. Plani mesimor TLD, Programi TLD, Tabela përmbledhese TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen</p>	<p>GVJ konstaton se dosja e programit Bachelor TLD ka të gjithë informacionin e duhur adresuar studentëve mbi kriteret e përgjithshme, specifikat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Kushtet dhe kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit Bachelor më “Teknikë e Lartë Dentare” janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit dhe aktet e brendshme rregullatore të Akademisë dhe bëhen të njohura për publikun përmes publikimit në faqen e web të AI, ku studentët kanë aksesë në çdo kohë ose përmes vizitës në sekretari, siç konfirmohet edhe nga Sekretarja e institucionit dhe studentët.</p> <p><i>[Ref. Dosja e Programit TLD, Rregullore e Programit të Studimit TLD, takim me Sekretarinë Mësimore dhe studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga studimi i syllabuseve të programit Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”, GVJ konstaton se syllabuset e secilës lëndë, përmbajnë informacionet e nevojshme e të detajuara në lidhje me objektivat e lëndës, tematikat e leksioneve dhe seminareve, orët brenda dhe jashtë auditorit, etj.</p> <p>Syllabuset gjithashtu, përmbajnë qëllimin, objektivat e lëndës/ modulit, ngarkesën, detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin dhe testimin si dhe vlerësimin përfundimtar të tyre.</p> <p><i>[Ref. Programi TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>GVJ nga diskutimet me stafin akademik dhe drejtuesit e AI konstatoi praktikën e punës se në fund të çdo viti akademik bëhet rishikimi i programit të studimit, ndryshimet dhe përmirësimet e nevojshme në përmbajtje të syllabuseve, duke përfshirë kontributin e aktorëve të ndryshëm, stafit akademik, studentët aktualë dhe alumni të programit, këshillimet me anëtarët e Bordit të Administrimit të AI dhe bashkëpunëtorë.</p> <p>Përmirësimi i syllabuseve fokusohet edhe në tematikat e laboratorëve e praktikave, që studentët të mund të jenë sa më afër problemeve të shumëllojshme me të cilat përballet tekniku dentar.</p> <p>Programi i studimit Bachelor TLD është riorganizuar në masën mbi 20%, sipas rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit në vendimin e tij nr. 20 datë 24.01.2020 dhe nuk mund të pësojë ndryshime mbi 20% para akreditimit të parë.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimet në institucion me personelin akademik të Departamentit të Protetikës dhe Sekretarinë mësimore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konkludoi se dosja e programit TLD, e cila përmban informacionet e nevojshme në lidhje me programin, planin mësimor, syllabuset, rregulloren etj., gjendet në format fizik pranë ambienteve të Sekretarisë mësimore dhe në faqen e web të institucionit. Programi Bachelor TLD ka plan mësimor i cili ka informacion të detajuar mbi lëndët, ndarjen në semestra dhe vite akademike, ngarkesën mësimore dhe shpërndarjen e orëve në leksione, seminare, detyrë/ projekt, pra orët brenda dhe jashtë auditorit. Dosja e programit Bachelor TLD ka të gjithë informacionin e duhur adresuar studentëve mbi kriteret e përgjithshme, specifikat e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Syllabuset janë të ndërtuara konform akteve nënligjore dhe përmbajnë informacionet e nevojshme për secilën lëndë. Programi i nënshtrohet akreditimit për herë të parë pas riorganizimit në masën mbi 20% në 2021,</i></p>

	<p><i>ndaj nuk mund të ndyshojë deri pas akreditimit të tij të parë. Por ka kaluar procese akreditimi në vitin 2013 dhe 2019 që kanë kontribuar në përmirësimin dhe riorganizimin e tij përmes rekomandimesh që janë vlerësuar drejt nga AI.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Bachelor TLD përbëhet nga lëndë që adresojnë qëllimin e tij në formësimin e dijeve teorike e aftësive praktike në fushën e teknikave dentare dhe dentistrisë estetike dhe që janë në përputhje me zhvillimet e tregut të punës. Kjo konfirmohet nga stafi ndihmës akademik që ka laborator dentar dhe nga studentët aktualë të punësuar në laborator dentar. Ky program ka natyrë thellësisht aplikative dhe mundëson aftësimin e studentëve në prodhimin e protezave dentare dhe aparate ortodontike në laboratorin dentar. Njohuritë e fituara nga ky program mundësojnë ndjekjen e studimeve të mëtejshme në programin Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” që ofrohet nga AI, apo programe të një fushe të ngjashme në institucione brenda dhe jashtë vendit.
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Elementët përbërës të programit (lëndët, shpërndarja në semestra e vite akademike, vlerësimi në kredite e orë mësimore, etj) mundësojnë arritjen e objektivave të tij. Në vitin e parë studentët formohen teorikisht në lëndë bazë si Anatomia Dentare, Anatomia, Histologjia dhe Biologjia e Qelizës, Materiale Dentare dhe paralelisht me to ushtrohen në aplikimin praktik të tyre në lëndët karakterizuese të teknikave të protezave e urave dhe kurorave. Kombinimi me të njëjtën logjikë i veprimtarive formuese vazhdon edhe në vitin e dytë e të tretë të studimeve, ku njohuritë mbi materialet dentare, bazat fiziko-kimike të teknikave dentare aplikohen nga studentët në punime praktike të shumta e shumëllojshme në laboratorët e praktikant mësimore.
<b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre është në përputhje me profilin e programit Bachelor. Përsa i përket raportit teori/ praktikë, nisur nga natyra profesionale e programit të studimit, ka një raport të balancuar të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (47:53). Ky raport është në përputhje me profilin e programit dhe me programe të tjera të ngjashme ndërkombëtare.
<b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Programi ruan raportet e paracaktuara me lëndë karakterizuese të tipit B me 103 kredite ECTS ose 57%; lëndë bazë të llojit A me 34 kredite ECTS ose 19%; lëndë ndërdisiplinore të llojit C me 25 kredite ECTS ose 14%; lëndë plotësuese të llojit D me 25 kredite ECTS ose 14% dhe detyrime përmbyllëse të llojit E me 6 kredite ECTS ose 3%.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	<p>[Ref. Plani mesimor TLD]</p> <p>Siç u përmend edhe më lart, raporti teori/ praktikë është në favor të praktikës, duke patur parasysh natyrën aplikative të programit. Specialistët e formuar janë të kërkuara nga tregu, siç konfirmohet nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe dokumenti i punësimit të studentëve brenda dhe jashtë vendit.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimet me personelin akademik dhe drejtuesit e Fakultetit, duke patur parasysh edhe faktin që programi është riorganizuar në 2021, GVJ vëren se nuk janë bërë ndryshime të mëtejshme të programit. Përsa i përket sylabuseve të lëndëve, institucioni ndjek praktikën e rishikimit të tyre në fillim të çdo viti akademik për të reflektuar zhvillimet më të fundit në materialet, metodat, aparaturat dhe instrumentat në fushën e teknikave dentare dhe dentistrisë. Institucioni po bën përpjekje për krijimin e një politike të standartizuar sipas ISO 21001:2018 për rishikim, vlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kurrikulës.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit garanton marrjen e njohurive, aftësitë dhe kompetencave të synuara në nivelin Bachelor. Referuar planit mesimor me lëndët respektive për çdo semestër, njohuritë vijnë duke u thelluar dhe zgjeruar nga një semestër në tjetrin, duke filluar nga punimet prototipe më të thjeshta e deri në punime të kombinuara e komplekse.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi u jep studentëve njohuritë që mund të merren në një sistem Bachelor, i ndihmon ata për ndjekjen e studimeve të avancuara, si dhe asiston ambiciet e studentëve për angazhime profesionale drejt tregut të punës. Stafi ndihmës akademik ka në përbërje 1 staf, i cili ka përfunduar Master Profesional pranë AI dhe nga bisedimet me studentë, rreth 70% e studentëve të Master Profesional në “Teknika digjitale Dentare” kishin përfunduar program Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare”. Duke shqyrtuar dokumentacionin dhe bisedën me studentët, GVJ konkludon se përmbajtja e programit të studimit është në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ, pas takimeve me zyrat mbështetëse, studentët dhe stafin akademik, dhe pas shqyrtimit të dokumentave të punësimit, arrin në përfundimet se përmbajtja e programit të studimit mundëson transferimin e dijeve dhe thellimin e mëtejshëm të njohurive përmes ndjekjes së Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” që ofron AI ose të programeve të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në hartimin e programit janë parë me interes programe studimi të ngjashme ndërkombëtare. Shpërndarja e njohurive në 3 vite akademike, ku në çdo vit rritet niveli i vështirësisë së njohurive teorike dhe praktike, mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Institucioni ndjek praktikën e rishikimit të sylabuseve në fillim të çdo viti akademik për të reflektuar zhvillimet më të fundit në materialet, metodat, aparaturat dhe instrumentat në fushën e teknikave dentare dhe dentistrisë. Gjithashtu, AI po bën përpjekje për krijimin e një politike të standartizuar sipas ISO 21001:2018 për rishikim, vlerësim dhe përmirësim të vazhdueshëm të kurrikulës.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përmbushet plotësisht.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

**Standardi II.5**

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga AI, GVJ vëren se institucioni ka një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione arsimore dhe biznese e profesionistë të fushës. Këto partnerë kontribuojnë në hartimin dhe përditësimin e syllabuseve dhe orëve të praktikës mësimore. Institucioni vlerëson edhe propozimet e studentëve alumni mbi përmbajtjen e programit.</p> <p><i>[Ref. takim me stafin drejtues, Analiza e përfitimeve nga Marrëveshjet Institucionale, Marrëveshja Ivodent - FMD UMT, Marrëveshje Ivodent - AU, Marrëveshje Ivodent - UPT, Marrëveshje Ivodent - Universiteti i Pancevo, Marrëveshje Ivodent - CIT, Marrëveshje Ivodent-AT Group dhe DCA Albania, Marrëveshje Ivodent DMCO, Marrëveshje Ivodent BBW Gjermani, Marrëveshja Mirora Ngjelina - Ivodent]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Në takimin me studentët, ata konfirmuan përfaqësimin e tyre në Senatin e AI dhe organizimin dhe funksionim të Këshillit studentor. Studentët nxiten të sjellin mendimet dhe sugjerimet e tyre nëpërmjet anketimeve të kryera nga NJSBC të cilat më pas diskutohen në mbledhjet e departamentit. Zyra e karrierës konfirmon se mban statistika mbi studentët alumni, është në kontakt të vazhdueshëm me ta dhe kërkon të vlerëson opinionin e tyre në ndihmë të programit të studimit dhe institucionit më gjerë. Punësimi i studentëve në zona të ndryshme të Shqipërisë dhe jashtë vendin, sjell eksperiencën të shumta në akademi.</p> <p><i>[Ref. PSV Mbledhje personeli akademik për diskutimin e analizës së cilësisë dhe aplikimit për programin e ri Master Shkencor]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Programi i nënshtrohet akreditimit për herë të parë, ndaj nuk mund të bëhen ende ndryshime thelbësore në program. Megjithatë, institucioni ka të përcaktuar në strategjinë e tij, përmirësimin, përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet e dhëna nga partnerët, bashkëpunëtorët, studentët alumni dhe ekspertët e fushës së teknikave dentare.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ ka krijuar mendimin e përbashkët mbi përmbushjen e këtij standardi bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga AI dhe takimet e zhvilluara me studentët dhe zyrat mbështetëse, ku AI ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, biznese dhe ruan kontaktet me studentët në ndihmë të përmirësimit dhe përshtatjes së programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Studentët e programit dhe alumni janë të</i></p>



	<p><i>përfshirë në vendimmarrje përmes Këshillit studentor dhe përfaqësimin në senat. Ata sjellin mendimet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me programin dhe institucionin edhe përmes anketave të realizuara nga NJSBC. Institucioni ka të përcaktuar në strategjinë e tij, përmirësimin, përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet e dhëna nga partnerët, bashkëpunëtorët, studentët alumni dhe ekspertët e fushës së teknikave dentare.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

#### Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Pas shqyrtimit të syllabuseve, vizitës në institucion si edhe bisedave me stafin dhe studentët, GVJ konfirmon që programi mësimor në Akademinë Ivodent zhvillohet duke kombinuar leksionet, seminarët, orët laboratorike, detyrat praktike/ projektet etj. Numër më të madh orësh zë pjesa praktike, duke qenë se qëllimi i këtij programi është aftësimi praktik profesional i studentëve. Duke u bazuar në planin mësimor, shpërndarja e orëve është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Leksione 710 orë</li> <li>- Seminare 290 orë</li> <li>- Detyra/projekte 190 orë</li> <li>- Laboratore 305 orë</li> <li>- Praktikë mësimore e profesionale 1,016 orë</li> </ul> <p>Total 2,511 orë.</p> <p>Institucioni sigurohet që programet e lëndëve të ndërtohen mbi bazën e elementëve në rregullore dhe procesi mësimor të zhvillohet në bazë të tyre.</p> <p>Raporti teori - praktikë: 47% - 53%.</p> <p><i>[Ref. Plani mesimor TLD, takimi me stafin dhe studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në mësimdhënie është i aftë të bashkëveprojë me studentët, duke ofruar metoda të ndryshme të mësimdhënies. Gjatë praktikave mësimore studentët realizojnë edhe punime të ndryshme protetike për pacientë realë, falë punëve që marrin nga tregu.</p> <p>Gjithashtu personeli i AI, nëpërmjet platformës Google Education, e cila është vënë në përdorim që në kohën e pandemisë Covid-19, vënë në dispozicion leksione, detyra dhe ushtrime të ndryshme, literaturë nga library online, për tu konsultuar nga studentët në çdo kohë. Falë kësaj metode, studentët kanë mundësi të komunikojnë vazhdimisht me titullarët e lëndëve.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin dhe studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Pas bisedave me stafin dhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konfirmon që personeli akademik dhe ndihmës akademik i AI merr pjesë në aktivitete të ndryshme si: workshope, konferenca, trajnime brenda dhe jashtë vendit, të cilat financohen nga institucioni. Kështu, stafi i AI është gjithnjë i azhornuar me të rejat më të fundit në fushën e dentistrisë dhe ja përcjell informacionet studentëve gjatë orëve mësimore.</p> <p>Personeli i AI gjithashtu planifikon zhvillimin individual të karrierës, duke u ndihmuar nga institucioni.</p> <p>Ndër të tjera, për të mbështetur dhe përmirësuar më tej format e mësimdhënies, AI ka investuar në teknologji të reja për realizimin e orëve mësimore, si: salla digjitale, pc, pajisja e çdo klase me videoprojektor,</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>salla laboratorike, aparatura të reja, pasurimi i bibliotekës fizike dhe online etj.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin, Financim pjesëmarrje në konferencë ADM, Athinë; Financim pjesëmarrje në konferencë Beograd, Financim për pjesëmarrje në konferenca brenda vendit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Pas bisedave me stafin dhe shqyrtimit të CV-ve të dorëzuara, GVJ vlerëson se personeli akademik dhe ndihmës akademik i AI ka përvojë të gjatë profesionale dhe plotëson kriteret ligjore të kualifikimit, sic përcaktohet në ligjin 80/2015. Pra, stafi i AI zotëron kompetencat e nevojshme për ofrimin e njohurive në lidhje me programin e studimit, si edhe në përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies për të përcjellë sa më mirë këto njohuri tek studentët.</p> <p>Gjithashtu NJSBC organizon 1-2 herë në vit anketime të ndryshme me studentët për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Nëpërmjet rezultateve të këtyre anketave, si edhe bisedave midis stafit dhe përgjegjësve të departamenteve, personeli akademik dhe ndihmës akademik është i aftë të përmirësojë metodat e mësimdhënies. Personeli i AI është i hapur ndaj formave të reja të mësimdhënies në përputhje me natyrën e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin, CV stafi akademik PAE TLD, CV stafi akademik PAK TLD ]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti përgjegjës për këtë program studimi vlerëson periodikisht personelin akademik dhe ndihmës akademik si edhe metodat e tyre të mësimdhënies, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e studentëve, shqetësimet e mundshme të tyre si edhe sugjerimet në lidhje me procesin mësimor. Kjo realizohet nëpërmjet anketave të ndryshme që kryhen në fund të çdo semestri, por edhe falë komunikimit të drejtpërdrejtë midis stafit dhe studentëve.</p> <p><i>[Ref. Shembull Ankete studentore, Raport NJSBC mbi Anketat, takimi me studentët dhe stafin]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konstatoi se Departamenti që ofron programin e studimit ka organizuar disa njësi brenda institucionit si: NJSBC, Senati dhe Bordi i Administrimit, të cilët angazhohen herë pas here në anketime të ndryshme ndaj studentëve dhe stafit, të cilat konsistojnë në vlerësimin e personelit të AI si edhe metodave të mësimdhënies. Rezultatet e këtyre anketave si dhe bisedimet/diskutimet e drejtpërdrejta me stafin dhe studentët, shërbejnë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>[Ref. Shembull Ankete studentore, Raport NJSBC mbi Anketat]</i></p>



<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se për programin TLD bazuar në dokumenta, Rregullorja e Programit të studimit si dhe Dosja e Programit përmbajnë detaje të hollësishme mbi shpërndarjen e orëve dhe planin mësimor, duke garantuar aftësimin profesional të studentit. Syllabuset janë të hartuara sipas standardeve dhe studentët informohen mbi to në fillim të çdo viti akademik. AI ka struktura të posaçme për vlerësimin e personelit akademik dhe formave të mësimdhënies/ mësimnxënies dhe mendimi i studentëve merret gjithmonë në konsideratë për ndryshime të mundshme. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret e institucionit dhe programit të studimit përcaktojnë qartësisht mënyrën e vlerësimin dhe kontrollit të njohurive. Studentët janë në dijeni të këtyre metodave të vlerësimin, pasi informohen në mënyrë të detajuar në fillim të vitit akademik. Këto rregullore janë publikuar gjithashtu online në faqen e webit të AI.  [Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent, Dosja e Programit TLD, Rregullore e Programit të Studimit TLD]
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimin të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo viti akademik, studentët njihen më syllabuset dhe informohen nga titullari i secilës lëndë mbi përmbajtjen e lëndës, temat, mënyrën e vlerësimin dhe kontrollit të dijeve përgjatë vitit si edhe në provimin përfundimtar. GVJ konstatoi që syllabuset janë të strukturuar sipas standardeve dhe respektojnë planin mësimor.  [Ref. Dosja e Programit TLD, Plani mesimor TLD]
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Mënyrat e vlerësimin dhe kontrollit të njohurive janë të përcaktuara qartë në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të programit mësimor. Studentët vlerësohen në detyrat/ projektet, provimet e ndërmjetme si edhe në provimin përfundimtar. Çdo vlerësim si edhe nota përkatëse u bëhet e ditur studentëve para hyrjes në provimin final. Studentët mund të konsultojnë në çdo kohë pikët dhe notat që kanë marrë gjatë vitit akademik edhe nëpërmjet portalit online që u është vënë në dispozicion nga institucioni.  [Ref. Dosja e Programit TLD]
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke	Departamenti përgjegjës për programin e studimit si edhe NJSBC monitorojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht mënyrën e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke organizuar anketa të ndryshme ose disuktime të drejtpërdrejta me studentët. Falë rezultateve të këtyre anketave dhe bisedimeve, është e mundur të merret mendimi i studentëve si edhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.

sugjerimet e tyre në lidhje me planin mësimor. Ato diskutohen në mbledhjen e Departamentit dhe shërbejnë në përmirësimin e procesit mësimor në vazhdim.

[Ref. Shembull Ankete studentore, Raport NJSBC mbi Anketat]

**Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Nga takimi me personelin akademik, GVJ vlerëson se stafi është i hapur ndaj përditesimit të formave alternative të mësimdhënies, në përputhje me programin e studimit. Falë platformës Google Education, stafi dhe studentët kanë lehtësi në komunikim në çdo kohë. AI vë në dispozicion ambientet laboratorike për studentët e punësuar ose prindër, të cilët kanë mundësi të kryejnë punimet dhe praktikat laboratorike deri në orën 20:00, edhe pas përfundimit të procesit mësimor gjatë ditës. Institucioni vë në dispozicion të plotë të studentëve literaturën profesionale, falë pasurimit të bibliotekës fizike dhe asaj online. Programi i studimit u jep mundësi studentëve të ushtrojnë aftësitë e tyre në mënyrë të pavarur gjatë praktikave laboratorike. Personeli akademik gjithsesi është në dispozicion të ndjekë nga afër studentët, dhe në rastet kur është e nevojshme të japë komentet dhe sugjerime për përvetësimin më të mirë të njohurive dhe aftësive praktike.

[Ref. Takimi me stafin dhe studentët]

**Konkluzione**

Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionin e dorëzuar, GVJ konkludon se AI ka hartuar rregullore të posacme, në të cilat është e përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të njohurive teorike dhe praktike të studentit. AI sigurohet që rregulloret të zbatohen plotësisht. Studentët njihen në fillim të vitit me syllabuset dhe mënyrën e vlerësimit përgjatë vitit akademik. Falë strukturave të ngritura nga institucioni, mësimdhënien dhe mësimnxënien monitorohen periodikisht dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.

**Shkalla e përmbushjes së standardit**

	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

**Standardi III.3**  
**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Duke u bazuar në analizën e syllabuseve të programit të studimit, si edhe takimit me stafin dhe studentët, GVJ konstatoi se përgatitja profesionale e studentëve mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve përgjatë vitit akademik. Testimi dhe vlerësimi i studentëve kryhet nëpërmjet kontrolleve të ndërmjetme, seminareve, detyrave/ projekteve, protokolleve të punëve laboratorike, provimit përfundimtar etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, si edhe takimin me personelin e AI, GVJ konstatoi se institucioni në vitet e fundit ka investuar në krijimin

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>vlërësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>e një sistemi elektronik të brendshëm, i cili shërben si mjet komunikimi midis studentëve dhe stafit, ku studentët mund të kontrollojnë gjithashtu, vlerësimet e fituara nga kontrollet e njohurive, sipas formave të sipërpërmendura. Studentët mund të logohen në këtë sistem nëpërmjet një adrese elektronike në website-n e institucionit, me të cilën pajisen në momentin e regjistrimit dhe aty njihen me komunikimet dhe njoftimet e postuara nga sekretaria ose pedagogu i lëndës. Studentët kanë akses vetëm në rezultatet personale të provimeve ose testeve.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin, Raport Infrastruktura 2022, Raport Infrastruktura Digjitale]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i njohurive për çdo lëndë bëhet në përputhje me syllabuset e çdo lënde si edhe Rregulloren e programit dhe Rregulloren e përgjithshme të AI.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent, Dosja e Programit TLD, Rregullore e Programit te Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe dokumentacioni i dorëzuar nga AI, vërehet se pas çdo provimi dhe testimi për kontrollin e njohurive, në varësi të natyrës së secilës lëndë, titullari i lëndës jep gjithashtu komentet dhe sugjerimet e tij mbi përmirësimet e procesit të të nxënit. Numri i kufizuar i studentëve të këtij programi, mundëson edhe komunikimin e drejtpërdrejtë e të vazhdueshëm midis studentëve dhe personelit, për përcjelljen e këtyre komenteve dhe sugjerimeve mbi përvetësimin e njohurive.</p> <p>Stafi gjithashtu ndjek nga afër studentët që kanë nevojë për përmirësim, jo vetëm mbi procesin e të nxënit, por edhe në përmirësimin e aftësive praktike.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin dhe studentët]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në aktet rregullatore të institucionit, rastet që dyshohen për kopjim, trajtohen si shkelje e rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Programit. Në këto raste student konsiderohet mbetës.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent, Rregullore e Programit te Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi dhe kontrolli i njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve bazohet në meritë dhe rezultatet jepen sipas kohës së përcaktuar në Rregulloren e programit dhe atë të institucionit. Sistemi i vlerësimit është ai me dhjetë nota. Rezultatet paraprake të testeve hidhen në sistem dhe u bëhen të njohura studentëve, ashtu si edhe komentet dhe sugjerimet nga titullari i lëndës/komisioni. Kjo garanton transparencë dhe siguri, si edhe respekton të dhënat personale.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Përgjithshme Ivodent, Rregullore e Programit te Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim</p>	<p>Studenti ka të drejtë të njihet me rezultatet e vlerësimit, të cilat hidhen edhe në sistemin online. Pas shpalljes së rezultateve, studentin ka të drejtë të njihet me fletën e provimit dhe nëse ka kundërshtime ose paqartësi mbi</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>notën ose mënyrën e vlerësimit, ka të drejtë të bëjë reklamimin e provimit, duke depozituar kërkesën e tij pranë sekretarisë.</p> <p>Sipas rregullores së programit, në raste të kundërshtimit të notës, ngrihet një komision i përshtatshëm për rishikim dhe rikorigjim të provimit. Gjithsesi, studentët kryesisht nuk kanë patur probleme të kundërshtimit të vlerësimit ose notës, pasi çdo paqartësi është diskutuar direkt me komisionin e vlerësimit të provimit.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se për programin TLD bazuar në takimin me stafin e AI, studentët, titullari i secilës lëndë u prezanton studentëve syllabusin si edhe mënyrën e vlerësimit që do të kenë përgjatë vitit akademik. Studentët njihen në kohë reale me rezultatet e punimeve, detyrave dhe provimeve të ndërmjetme që kryejnë përgjatë vitit. AI përcakton qartë në Rregulloren e Përgjithshme dhe atë të Programit mënyrën e vlerësimit të studentit dhe sigurohet që ky vlerësim të jetë i drejtë dhe transparent. Studentët janë në dijeni të procedurave që duhet të ndjekin në rast ankimi ose kontestimi të notes.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ vlerëson se programi i studimit Bachelor në TLD ofron njohuritë e nevojshme për formimin e specialistëve në fushën e teknikave dentare, si edhe garanton rritjen dhe thellimin e njohurive dhe aftësive praktike nga njëri vit në tjetrin. Çdo lëndë e planit mësimor ka të përcaktuar qartë numrin e orëve për formimin teorik dhe praktik të studentit. Kurrikula e programit garanton përfundimin e njohurive të nevojshme për formimin e studentit në funksion të profesionit të teknikave dentare, si edhe mundëson orë të shumta praktike për tu zhvilluar profesionalisht.</p> <p><i>[Ref. Dosja e Programit TLD, Plani mesimor TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor të këtij programi, orët mësimore janë të balancuara midis lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmblylëse (veprimtaritë formuese A-E). Studentët kanë mundësi të mësojnë edhe gjuhë të huaj, si p.sh.: “Anglisht” (lëndë e tipit D) si edhe të marrin njohuri të përgjithshme nëpërmjet lëndëve “Kujdesi për shëndetin dentar” ose “Anatomi” (lëndë të tipit A).</p> <p><i>[Ref. Dosja e Programit TLD, Plani mesimor TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në</p>	<p>Në përfundim të secilës lëndë, studenti vlerësohet për njohuritë e marra si edhe kompetencat e fituara. Gjatë javës së fundit të semestrit, pedagogu</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>realizon një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave që synoheshin të arriheshin nga studentit. Titullari i lëndës analizon dhe vlerëson aftësitë e fituara nga studentit dhe ndan me të rezultatet dhe ecurinë e lëndës, duke parashikuar ndërhyrje përmirësuese në varësi të rezultateve dhe sugjerimeve të studentëve. Më pas studentit orientohet mbi temat ku do të përqendrohet përgatitja e tij për provimin përfundimtar.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin, Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikën profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit konsiston në gërshetimin e orëve teorike dhe praktike, në mënyrë që studentët të zbatojnë në praktikë njohuritë e përfuara. Falë infrastrukturës laboratorike të avancuar që AI zotëron, studentët kanë mundësi të testojnë kompetencat e fituara në laboratorët ku zhvillohen orët praktike. Gjithashtu, studentët realizojnë detyra ose projekte në grup prej 3-4 personash, ku testojnë njohuritë apo aftësitë e fituara, sipas udhëzimeve të titullarit të lëndës.</p> <p>Falë detyrave të kursit apo projekteve të ndryshme që u jepen studentëve, personeli akademik dhe ndihmës akademik inkurajonë studentët të zhvillojnë ide dhe metoda inovative për realizimin e punimeve të tyre, si edhe në gjetjen e zgjidhjes së duhur në rast të shfaqjes së ndonjë difekti të punimit. Këto difekte ose problematika shndërrohen më tema të kërkimeve të mëtejshme, duke u kthyer në detyra të tjera kursi, projekte, etj.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin dhe studentët]</i></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli i AI sigurohet të integrojë të rejtat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë në njohuritë që u përcillen studentëve gjatë realizimit të planit mësimor. Gjithashtu, herë pas here AI fron pedagogë të universiteteve me të cilat bashkëpunon, për të realizuar orë leksioni mbi zhvillimin e konferencave të ndryshme që përfshijnë gjithashtu të rejtat më të fundit nga fusha e teknikave dentare.</p> <p><i>[Ref. Takimi me stafin]</i></p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ konkludon se ky program studimi ofron të gjitha njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike për formimin profesional të teknikut dentar. Orët teorike dhe praktike janë të balancuara, në mënyrë që ti japin hapësirë studentit të zhvillojë në praktikë njohuritë e marra gjatë leksioneve. Personeli i AI sigurohet që studentët të kenë përvetësuar sic duhet njohuritë e përfuara. Ata gjithashtu përfshijnë metoda të reja të mësimdhënies, duke integruar të rejtat më të fundit të fushës dhe teknologjisë.</p> <p>AI ofron infrastrukturën e përshtatshme që studentët të realizojnë punimet e tyre laboratorike dhe detyrat praktike.</p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


**Standardi III.5**

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>Në Rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë rregullat dhe procedurat mbi detyrimet përmbyllëse të studentit. Provimi përfundimtar mbart 6 kredite ECTS. Studenti mund të zhvillojë provimin përfundimtar vetëm pasi ka shlyer detyrimet përmbyllëse. Ai ndjek një procedurë të posaçme për mbrojtjen e diplomës dhe dhënien e provimit përfundimtar, pas përfundimit me sukses të të cilit, studentit diplomohet.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve për përgatitjen e provimit përfundimtar, janë pedagogët udhëheqës, të cilët ndjekin nga afër detyrat, praktikat etj. Ata realizojnë gjithashtu takime informuese mbi organizimin dhe realizimin e provimit. Studentët kanë gjithashtu në dispozicion manuale për t'u përgatitur dhe gjejnë njoftime dhe informacione të ndryshme pranë Zyrës së Shërbimit ndaj studentëve ose në faqen zyrtare të AI.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD, Fletë vlerësimi praktike, Fletë provimi e korigjuar]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të kryejë provimin përfundimtar pasi ka shlyer të gjitha detyrimet përmbyllëse. Ai testohet dhe vlerësohet për disa module që ka zhvilluar gjatë programit të studimit. Përmbajtja e provimit bazohet në prodhimin e një proteze dentare komplekse në një periudhë 2 javore, me elementë nga lloje të ndryshme protezash që studentit ka realizuar gjatë studimeve. Studenti vlerësohet gjithashtu edhe nga ana teorike përpara një komisioni të miratuar nga Dekani.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Pasi njihen me procedurat e provimit përfundimtar, udhëheqësi i diplomës ndihmon studentët në përgatitjen për provim. Ai ndjek nga afër pjesën praktike, si edhe organizon takime informuese me studentët mbi mënyrën e organizimit të provimit. Udhëheqësi i provimit gjithashtu u vë në dispozicion studentëve materiale dhe informacione të nevojshme gjatë përgatitjes dhe realizimit të detyrave.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>AI vendos në dispozicion të studentëve infrastrukturën e saj, për realizimin e detyrave dhe praktikave profesionale. Në rastet kur studentët realizojnë punë nga tregu për pacientë realë, AI u rekomandon studentëve realizimin e punimit në klinikat me të cilat institucioni bashkëpunon. Gjithashtu, AI vendos në dispozicion të studentëve edhe laboratorët e Qendrës së Studimit të Tëknikave, ku mund të kryejnë matje ose të testojnë rezistencën e materialeve të ndryshme ndaj temperaturës.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve akademike dhe kryerjes së provimit përfundimtar, studentit vlerësohet me notë, duke fituar kështu kreditet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	respektive. Organizimi i provimeve dhe vlerësimit të njohurive realizohet në përputhje me syllabuset dhe Rregulloren e Programit.			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me Diplomë dhe Suplementin e Diplomës (në gjuhët shqip dhe anglisht), të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Pas përfundimit të studimeve, në çdo rast që kërkohet nga studenti, Sekretaria mësimore vë në dispozicion të tij kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit.  [Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD, Rregullore e Përgjithshme Ivodent]			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në aktet rregullatore në fuqi dhe Rregulloret e institucionit, sekretaria mësimore ruan regjistrat bazë të studentëve, që përmbajnë të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë studimeve, certifikata etj. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve dhe përpunon të dhëna statistikore, sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjensisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë apo nevojave të vet institucionit. Regjistrat e tyre ruhen në formë të shkruar dhe elektronike për një kohë të pacaktuar.  [Ref. Rregullore e Programit të Studimit TLD, Rregullore e Përgjithshme Ivodent]			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konkludon se për programin e studimit TLD të Departamentit të Protetikës, AI ka të përcaktuar qartë në Rregulloren e Programit rregullat dhe procedurat për detyrimet përmbyllëse të studentit. Studentët njihen me Rregulloren që në ditën e parë dhe AI e ka bërë atë publike edhe në faqen zyrtare online. AI vendos në dispozicion të studentit infrastrukturën laboratorike, materialet dhe aparaturat e nevojshme, për realizimin e punimeve laboratorike si edhe të provimit përfundimtar.</i></p> <p><i>Studentët udhëhiqen nga pedagogët përkatës për realizimin e provimit përfundimtar, ata orientohen dhe ndihmohen për përgatitjen e tyre për provim. Ata kanë gjithashtu në dispozicion manuale të ndryshme që mund ti ndihmojnë në përgatitje. Studentët pajisen me diplomë dhe suplementin e diplomës pas përfundimit me sukses të studimeve. Në çdo rast një kopje e këtij dokumentacioni ruhet në Sekretarinë Mësimore të AI.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor “Teknikë e Lartë Dentare”, fakulteti i Teknikave Dentare përmbush kërkesat ligjore sipas LAL dhe marrëveshjes për staf të reduktuar me MAS për kualifikimin akademik, drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e programit në përputhje me fushën e studimit dhe veçoritë e saj specifike.</p> <p><i>[Ref. Marrëveshja MASR – Ivodent, Organigrama, Dosja e Programit TLD, Shpërndarja e orëve TLD 22-23]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli efektiv i AI mbulon 70% të ngarkesës mësimore sipas marrëveshjes me MAS dhe shpërndarja respekton VKM nr 41 datë 24.01.2018 (i ndryshuar).</p> <p><i>[Ref. Marrëveshja MASR – Ivodent, Organigrama, Shpërndarja e orëve TLD 22-23, Verifikimi i kapaciteteve MAS]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Akademia Ivodent nëpërmjet referencave ka dëshmuar qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv dhe me kontratë nëpërmjet listëpagesës së stafit dhe shembujve të kontratave të punës. Takimi me stafin akademik konfirmoi plotësimin e kriterit.</p> <p><i>[Ref. Listëpagesa e stafit, Shembull kontrate PAE, Shembull kontrate PAK]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka një procedure rekrutimi transparente dhe të strukturuar, e cila synon përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit. Njoftimet vihen në dispozicion në mënyrë publike nëpërmjet faqes së interentit të institucionit. Procedurë e konfirmuar dhe në takimet me stafin administrativ gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>[Ref. Procedurë e punësimit dhe shpallje vakance]</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Dega Bachelor TLD ka një natyrë specifike teknike, ku praktika profesionale dhe laboratorike kanë fokus primar. Mjediset laboratorike të Akademisë Ivodent janë të shumta, të pajisura me teknika, teknologji dhe aparate profesionale dhe të një spektri të gjërë punimesh dentare. Për këtë arsye, vihet re angazhim i lartë në zhvillimin e programit mësimor të personelit ndihmës akademik. Personeli ndihmës akademik është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe sigurinë e mjediseve laboratorike dhe për instruktimin praktik nëpërmjet protokolleve për procedura pune të stabilizuara. Nëpërmjet bashkëpunimeve me kompanitë prodhuese, Akademia Ivodent kualifikon në mënyrë të vazhdueshme stafin akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>[Ref. Organigrama, Raporti i Infrastrukturës, Dokumentacioni i kualifikimit të stafit ndihmës akademik, Shembuj protokollesh laboratorik, Analizë e marrëveshjeve institucionale]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Të dhënat përditësohen nga departamentet në format tabelash përmbledhëse për çdo vit akademik. Nuk raportohet për zbatim të ligjit të mbrojtjes së të dhënave personale, por ndiqet rregullorja e Arkivës për arkivimin dhe venien në dispozicion të dokumentacionit.</p> <p><i>[Ref. Tabela përmbledhëse TLD, Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të dhuruar e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Akademia Ivodent ka një lidhje shumë të ngushtë me kompanitë prodhuese të cilat trajnojnë në mënyrë frekvente stafin dhe studentët. Marrëdhënie institucionale ka ndërtuar dhe me biznesin vendas, në të cilët studentët kryejnë praktika profesionale dhe punësohen. Marrëdhëniet janë konkretizuar dhe rregulluar me protokolle dhe procedura kontrolli javore. Marrëdhëniet me laboratorët dentar janë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>[Ref. Analiza e përfitimit nga marrëveshjet Institucionale, Dëshmi javore e Praktikës Profesionale nga Laboratori]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktikat profesionale janë të rregulluara nëpërmjet kontratës së nënshkruar midis laboratorit pritës dhe fakultetit. Puna e studentit kontrollohet në mënyrë periodike dhe vërtetohet nëpërmjet dëshmisë javore të praktikës profesionale.</p> <p><i>[Ref. Analiza e përfitimit nga marrëveshjet Institucionale, Dëshmi javore e Praktikës Profesionale nga Laboratori]</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



<b>Konkluzione</b>	<p>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet e përcaktuara për garantimin dhe plotësimin e objektivave dhe pritshmërisë së programit me specifikat e tij. Personeli zotëron kualifikimin e duhur dhe Institucioni dëshmon përkushtim në trajnim të vazhdueshëm të stafit.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Akademia Ivodent është institucion me numër të ulët studentësh. Specifika e profesionit është praktika e nevojshme që studentët duhet të kenë përgjatë viteve të studimit dhe Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme në hapësirë, cilësi dhe llojshmëri të teknikave dhe punimeve që studiohen. Nëpërmjet dokumentacionit por dhe takimit në Institucion evidentohet infrastruktura laboratorike si pikë e fortë.</p> <p>[Ref. Raporti i Infrastrukturës, Raporti i Infrastrukturës Digjitale, Dosja e Programit, Tabela përmbledhëse]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Akademia Ivodent është ofruesi i vetëm në vendin tonë me program studimi në teknika digjitale dentare, me qasje të tillë ajo përfshin në përditshmërinë e zhvillimit të programit mësimor mjete informatike për realizimin e plotë teorik dhe praktik. Evidentohet se pas pandemisë së COVID, institucioni ka vazhduar të përdori mjete informatike të komunikimit midis stafit dhe studentëve, duke shfrytëzuar këto kapacitete për rritjen e interesit të studentëve përkundrejt profesionit.</p> <p>[Ref. Raporti i Infrastrukturës, Raporti i Infrastrukturës Digjitale]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Labororet e Fakultetit të Teknikave Dentare janë të pajisura me aparate dhe teknika të avancuara të teknologjisë dentare. Ato sigurojnë një njohje të plotë gjithëpërfshirëse të teknikave që një profesionist duhet të ketë për tregun e punës. Programi i studimit Bachelor synon të përgatiti profesionistin e plotë i cili njih mirë të gjithë proceset e punës për t'iu përgjigjur kërkesave të pacientëve. Nga vizita në institucion evidentuam që studentët punojnë në përditshmëri në hapësira të bollshme laboratorike me asistencën e duhur profesionale dhe me teknologji moderne.</p> <p>[Ref. Raporti i Infrastrukturës, Raporti i Infrastrukturës Digjitale]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të</p>	<p>Akademia Ivodent nuk disponon një hapësirë të dedikuar teknologjisë së informacionit, për shkak të profilit të saj. Por dëshmohet se të gjitha</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	hapësirat janë të mbuluara dhe të aksesueshme me teknologjinë e nevojshme për përmbushjen e programit të studimit.  Mjediset e bibliotekës janë të pajisura dhe kompjutera të lidhur në rrjet dhe me softwarët e nevojshëm për kërkim shkencor apo praktika mësimore.  [Ref. Raporti i Infrastrukturës, Raporti i Infrastrukturës Digjitale, Tabela përmbledhëse]		
<b>Konkluzione</b>	GVJ evidenton nëpërmjet dokumentacionit dhe vizitës që Institucioni përmbush plotësisht, të gjitha nevojat infrastrukturore për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik në mënyrë tepër adeguate me profilin e degës. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura e vënë në dispozicion për studentët e Bachelor “Teknikë e Lartë Dentare” është e përditësuar dhe e mjaftueshme për njohuritë e nevojshme teorike. Materialet didaktike u jepen falas studentëve sipas përcaktimit në Kontratën e Studentit. Veçoria e profesionit mirëkupton numrin e reduktuar të titujve në gjuhën Shqipe, por vihej re plotësimi i rekomandimeve të mëparshme për pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj librash nga shtëpitë prestigjioze të botimit ndërkombëtarë. Evidentohet nga takimi me studentët interesim i ulët në përdorimin e bibliotekës dhe revistave on-line të ofruara nga institucioni.  [Ref. Fondi i bibliotekës, Libraria online R4Life, Pasurimi i fondit të bibliotekës]
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	Nuk evidentohet apo dokumentohet procedurë për raportimin e literaturës nga njësitë përgjegjëse. Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion kërkesat për përditësimet të literaturës zhvillohen në mbledhjet e departamenteve dhe u kërkohen në mënyrë periodike çdo fillim viti akademik.  [Ref. PSV Mbledhje Departamenti per diskutimin e buxhetit 2022-23 dhe koordinatori]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Kapacitetet e bibliotekës janë të mjaftueshme për numrin e studentëve në Akademinë Ivodent. Biblioteka funksionon sipas rregullores së saj dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



	<p>nuk evidentohen pika kritike, të cilat mund të diskriminonin shfrytëzimin e drejtë të saj.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e Akademisë Ivodent është e pajisur me tituj fizikë, digjital dhe librari online në revista shkencore të fushës mjekësore. Natyra specifike e profilit të Akademisë përfaqëson një numër të limituar botimesh, por vihet re dëshira dhe trendi për pasurimin e bibliotekës me botime në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Gjithashtu, konstatojmë një numër më të pakët të literaturës në formë hard-copy në fushën e teknologjisë dentare.</i></p> <p>Vlerësojmë se literatura është e mjaftueshme për plotësimin e nevojave të programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Fondi i bibliotekës, Libraria online R4Life, Pasurimi i fondit të bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ofron pa pagesë shërbimet e bibliotekës dhe përdorimin e revistave online të abonuar.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ka 13 vende pune kompjuterike të pajisura me softwarët bazë dhe softwarë profesional ku studentët mund të ushtrohen dhe të njohin teknikat digjitale të profesionit.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Kapacitetet e bibliotekës janë të mjaftueshme për numrin e studentëve pranë Akademisë Ivodent. Zgjerimi i kapaciteve vihet re në përputhje me ritjen e numrit të studentëve. Shërbimi i bibliotekës zhvillohet në përputhje me Rregulloren e bibliotekës.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e bibliotekës]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Raportim mbi cilësinë e fondit të bibliotekës realizohet në mënyrë vjetore nga Departamentet përkatëse. Njëkohësisht me raportin plotësohet dhe kërkesa për pasurimin e fondit me titujt e rinj sipas kërkesës së stafit akademik.</p> <p><i>[Ref. PSV Mbledhje Departamenti per diskutimin e buxhetit 2022-23 dhe koordinatori]</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<p><i>Evidentohet dhe vlerësohet se Fakulteti i Teknikave Dentare përmbush të gjitha kriteret e specifikuar në standard, duke plotësuar të gjitha nevojat për zhvillimin e programit të studimit dhe krijimit të hapësira për zhvillimin e kërkimit shkencor. Fondi i literaturës së nevojshme është i plotë dhe u ofrohet studentëve pa pagesë, por vlerësojmë se impenjim të vazhdueshëm duhet të tregohet në pasurimin e plotë drejt fushës së gjërë të dentistrisë, duke mos u kufizuar vetëm në programet e ofruara nga Akademia.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni dëshmon për përdorim të sistemit të menaxhimit në nivele administrative dhe pedagogjike, ku zyrat përgjegjëse ndërlihen duke shkëmbyer informacione dhe duke aksesuar sipas nevojave informacionet e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor dhe nevojave të studentëve apo institucionit. Studentët kanë në përdorim një software, i cili aksesohet nga aparatet e tyre smartphone apo kompjuter për të aksesuar në të dhënat e tyre personale, listat e notave dhe detyrimeve financiare.</p> <p>Institucioni është në hapat e parë për të implementuar një sistem të ri, sipas metodologjisë Agile të quajtur QWiki, e ndërtuar duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare (ISO) për Institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p><i>[Ref. Shërbimet digjitale studentore, Formulari i Aplikimit Q.Wiki]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe vizitës në Institucion, evidentohet një funksionim i mirë i sistemit të menaxhimit dhe komunikimit institucional. Patëm mundësi të njiheshim dhe me arkivin e institucionit, ku dokumentat ruhen në format fizik. Arkiva funksiononte sipas Rregullores së Arkivës.</p> <p>Sistemet informatike ofronin informacione dhe shërbime specifike për secilën kategori përdoruesi, si staf administrative, staf akademik apo student, duke ruajtur praktikat e mira të përpunimit të drejtë të informacionit.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Arkivës]</i></p>




<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Interaktiviteti i stafit dhe studentëve realizohet nëpërmjet platformës Google Education, të cilën Akademia Ivodent e ka aktive qysh pas periudhës së pandemisë COVID-19. Përdorimi i kësaj platforme ofron mundësi dhe shërbime të ndryshme për shkëmbim informacioni dhe materialesh didaktike në formate të ndryshme.</p> <p><i>[Ref. Kontratë Shërbimi Google Education – Ivodent, Shërbimet digjitale studentore]</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Raportimet dhe komunikimet në Akademinë Ivodent janë përgjegjësi e zyrave apo departamenteve specifike, me ndërmjetësimin e Sekretarisë mësimore, për shkak të numrit të ulët të stafit dhe për rritje të efikasitetit dhe efijencës. Mungon sistemi i centralizuar por është në strategjinë e zhvillimit dhe evidentohen hapat e pare drejt adoptimit të një software të ri të quajtur QWiki.</p> <p><i>[Ref. Rregullore sekretarise mesimore, Formulari i Aplikimit Q.Wiki]</i></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur nga institucioni dhe nga verifikimi i GVJ, vërtetohet se Institucioni ka një faqe interneti publike që reflekton detaje të vërteta dhe informacione specifike të nevojshme lidhur me programin e studimit. Faqja e internetit sipas evidencave është e përkthyeshme në gjuhë të tjera sipas nevojës së përdoruesit.</p> <p>Informacione lidhur me programin dhe profesionin, Institucioni i komunikon edhe nëpërmjet rrjeteve sociale në gjuhën shqipe.</p> <p><i>[Ref. Website dhe rrjete sociale]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ vlerëson nëpërmjet dokumentave të vëna në dispozicion dhe vizitës në Akademi, se Institucioni përmbush nevojat operative të komunikimit dhe ndërveprimit brenda zyrave dhe departamenteve. Akademia Ivodent është në hapat e parë konkret për implementimin e një sistemi menaxhimi të qendëruar të bazuar në standardet ISO të arsimit të lartë. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të</p>	<p>Institucioni vepron konform LAL dhe ligjeve të menaxhimit buxhetor. Akademia i nënshtrohet auditit periodik financiar dhe dorëzon në MAS raportet vjetore analitike. Shoqëria themeluese përfaqësohet në Bordin e Administrimit, duke siguruar prej vitesh mbarëvajtjen e programeve të studimit edhe në kohën kur Akademia kishte një numër shumë të ulët të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>studentëve. Hartimi i buxhetit evidentohet të jetë gjithëpërfshirës nga departamentet përkatëse dhe departamentet dëshmojnë të kenë politika të shëndosha përfshirjeje të të gjithë aktorëve, duke shfrytëzuar dhe faktin e të qenurit një institucion i vogël. Nga vizita në Institucion GVJ vlerëson që janë të përmbushura të gjitha nevojat logjistike, infrastrukturore dhe teknologjike për mbarëvatjen e programit të studimit.</p> <p><i>[Ref. Organigrama, Rregullore e Bordit të Administrimit, Raport i Auditit, Raport Analitik, Raport Vjetor]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nëpërmjet dokumentave të vëna në dispozicion dhe nga vizita në Institucion dëshmohet se buxhëti është i mirë-planifikuar dhe i segmentuar sipas nevojave të departamenteve apo zyrave të tjera mbështetëse. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion vërtetohet se menaxhimi i përgjithshëm financiar është i mirëkontrolluar.</p> <p><i>[Ref. Raport Analitik, Raport Vjetor, Raport i Auditit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni ka vënë në dispozicion raportet periodike të auditit dhe raporte të tjera të dorëzuara në MAS për qëndrueshmërinë e Akademisë Ivodent.</p> <p><i>[Ref. Raport Analitik, Raport Vjetor, Raport i Auditit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në nivel departamenti diskutohet për buxhetin e vitit pasardhës dhe gjithashtu realizohet raportimi i realizimit të buxhetit. Dëshmuar kjo nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në Institucion në takimet me përgjegjësit e departamentit dhe stafit akademik.</p> <p><i>[Ref. PSV Mbledhje Departamenti per diskutimin e buxhetit 2022-23 dhe koordinatori, Procedure miratim buxheti, Raportim mbi realizimin e buxhetit nga departamenti]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Kompania themeluese ka qënë mbështetëse e Akademisë në periudhën kur numri i studentëve ka qënë shumë i ulët. Me zhvillimin e Akademisë dhe shtimin e programeve të studimit, raportet financiare tregojnë qëndrueshmëri dhe shëndet financiar. E vërtetuar kjo dhe me investimet teknologjike të konsiderueshme.</p> <p><i>Duke marrë në konsideratë këtë tregues të rritjes së numrit të studentave, institucioni mbështetet tek tarifa e studimit të studentëve dhe haset në vështirësi financiare në diversifikimin e burimeve të financimit.</i></p> <p>Versaliteti i Institucionit në rastin e përmbushjes së rekomandimeve të Akreditimit të mëparshëm, tregon seriozitet dhe rigorozitet për t'iu</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


	<p>përgjigjur me ndërhyrje financiare në pikat më pak të forta të akademisë, si shtimi i fondit të kërkimit shkencor dhe pasurimi i fondit të bibliotekës.</p> <p>[Ref. Raport mbi plotësimin e rekomandimeve të BA për akreditimin institucional, Raport mbi plotësimin e rekomandimeve të BA për akreditimin TLD i vjeter, Projekti kërkimi Shkencor 2022 HAp Altin Mele, Projekti kërkimi shkencor 2022 Lorenci Gjurgaj, Pasurimi i fondit të bibliotekës]</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni ka operuar në kushte të vështira financiare në vitet e kaluara, por investimi i kryer ka qenë i plotë, duke siguruar rritje graduale dhe konsistente përgjatë viteve. Në momentin ku ndodhemi, Institucioni njihet të numrit të studentëve, programeve të studimit dhe rrjedhimisht të financave. GVJ vlerëson se Institucioni është i qendrueshëm financiarisht dhe i përgjigjet sipas kërkesave ligjore të gjitha nevojave të IAL si kërkimi shkencor dhe realizimi i plotë i programit mësimor.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b>.</p>			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV</b>		<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dorëzuara nga Akademia Ivodent (AI) vërehet se pranimi i kandidatëve për student kryhet në përputhje me kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes, të miratuara nga Senati i AI, në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015.</p> <p>Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme, janë të parashikuara në Rregulloren e AI dhe gjenden të publikuara në faqen elektronike të AI. Kandidati duhet të ketë përfunduar Maturën Shtetërore në vend ose të ketë njehsuar atë pranë QSHA, kur kryhet jashtë vendit me vlerësimet e konvertuara sipas sistemit shqiptar. Kandidatët renditen sipas meritës së notës mesatare dhe plotësojnë kushtin e mesatares sipas VKM në fuqi. Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese, fushatat informuese në mediat sociale dhe drejtpërdrejt në institucion.</p> <p><i>[Ref. Website Bachelor, Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit TLD. Në rregulloren e programit TLD, neni 31 mbi procedurat dhe kriteret e pranimit në programet e ciklit të parë parashikon qartësisht të drejtat identike për çdo student prej fillimit e deri në përfundim të studimeve. Moszbatimi i saj parashikon në Rregulloren e kodit të etikës pasoja për shkelësit kur rastet shqyrtohen nga Komisioni i Etikës i AI.</p> <p><i>[Ref. Rregullore Departamenti, Rregullore Fakulteti Ivodent, Shembuj protokolle laborator]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ vëren bazuar në dokumentat e dorëzuara nga AI se institucioni ka një praktikë të miratimit të kriterëve të pranimit konform akteve të brendshme. Pranimi i kandidatëve bëhet në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të AI. MAS ngre një grup pune i cili verifikon kapacitetet pritëse të AI për kuotat e paracaktuar dhe më pas bën miratimin e kuotave. Renditja e maturanëve bëhet vetëm mbi bazën e mesatares së shkollës së mesme dhe nuk aplikohen kriteret e tjera shtesë për pranimin në programin TLD.</p> <p><i>[Ref. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 20-21, Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 21-22]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të</p>	<p>GVJ vëren bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, se AI bën publike përmes faqes së saj web procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të transferimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Ato pasqyrohen edhe në rregulloren e programit TLD dhe i dorëzohen në MAS konform akteve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>nënligjore për arsimin e lartë. Cdo i interesuar mund të informohet e këshillohet në Zyrën e Mbështetjes së Studentit të AI, që mundësohet lirisht edhe për shkak të numrit të kufizuar të studentëve në AI.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Numri maksimal i studentëve që mund të rregjistrohen dhe përzgjedhja e tyre sipas mesatares bëhen publike në cdo fillim viti akademik, para fillimit të rregjistrimeve. Ato janë të aksesueshme nga të gjithë të interesuarit si në faqen web të Ai, në portalin UAlbania, dhe në brushurat e fletpalosjet e shpërndara apo të disponueshme në institucion.</p> <p><i>[Takimet në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ vë re se AI aplikon politika lehtësuese për studentë që vijnë nga shtresa në nevojë duke aplikuar për ta bursa studimi deri në 50%. Por nuk aplikon kritere te vecanta përzgjedhëse për kandidatë me aftësi ndryshe apo pakica.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit te Studimit TLD, Kontrate-studenti-TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e AI vë re se studimet në programin TLD mund të ndiqen edhe nga studentë të huaj. Në vendimet e Senatit për kriteret dhe kuaotat janë të parashikuara kuota të vecanta për studentët nga trojet dhe studentët e huaj. Kriteret për përzgjedhjen e tyre janë të specifikuar dhe bëhen publike para rregjistrimeve në cdo vit në faqen e internetit të AI dhe në mediat sociale. AI nuk ka vendosur kritere shtesë përzgjedhëse hyrëse në program për kandidatët nga shtetet e tjera krahas mesatares 6.5 të përcaktuar me VKM.</p> <p><i>[Ref. Vendim Senati dhe miratim (kuota+kritere) 22-23]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Politikat e mbështetjes me bursa për studentë nga shtresa në nevojë pasqyrohet në Rregulloren e programit TLD dhe në kontratat që AI lidh me studentët e këtij programi. Studentët të cilët kur kanë prindër invalidë apo që përfitojnë asistencë sociale, përfitojnë reduktim prej 50% të tarifës së studimit pasi kalojnë një test në hyrje. Ndërsa studentët me mesatare të shkollës së mesme mbi 9, përfitojnë reduktim prej 10% të tarifës.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e Programit te Studimit TLD, Kontrate-studenti-TLD]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga AI si Rregullorja e Programit TLD, kontrata me studentin, broshurën informuese mbi programin TLD, informacionin në faqen e internetit të AI, informacionin në portalin UAlbania, si edhe takimet në institucion me personelin akademik, studentët e personelin administrativ, dhe dokumenta transferimesh, njohje kreditesh nga programe të tjera etj., të vëna në dispozicion nga Sekretaria, vë re se AI dhe Departamenti i Protetikës aplikojnë politika të qarta, transparente dhe të drejta që garantojnë barazi të plotë të kandidatëve dhe studentëve. Ato respektojnë aktet nenligjore dhe të brendshme lidhur me pranimin, ndjekjen e përparimit dhe diplomimin e studentëve dhe komunikojnë konform legjislacionit me MAS dhe agjensitë e saj dhe veprojnë konform konstatimeve të MAS mbi kapacitetet infrastrukturore dhe akademike të AI.</p>



	<p><i>AI ka një Komision funksional të Etikës për raste shkeljesh të të drejtave. Kontrata me studentin përmban të gjitha elementet e kërkuara nga ligji dhe parashikon bursat dhe reduktimin e tarifës për studentët nga shtresa në nevojë dhe ekselentë. Por, mungon një politikë e vecantë për studentët që vijnë nga komunitetet rom, egjyptian, dhe me aftësi të vecanta, megjithëse duhet theksuar fakti se është një institucion i vogël që nuk është ballafaquar me kërkesa të kësaj natyre deri më tani. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit TLD, faqes së internetit si edhe takimit me përfaqësues së AI, GVJ konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren e programit të studimit në pikën “Kalimi në vitin pasardhës” dhe aktet e tjera rregullatore. Kjo pikë ka informacionin e mëposhtëm se; Pas kalimit të sezonit të riprovimeve, ka të drejtë të zhvillojë studimet në vitin pasardhës, studenti i vitit të parë që rezulton me të paktën 30 (tridhjetë) kredite dhe studenti i vitit të dytë me të paktën 60 (gjashtëdhjetë) kredite. Ndërsa pika pasardhëse: Në rast se studenti, pas sezonit të riprovimeve në shtator, nuk ka fituar kreditet e nevojshme për të vazhduar vitin pasardhës, sipas pikës më sipër, shpallet “përsëritës”. Ai duhet të rifrekuentojë përsëri lëndët në të cilat nuk është kualifikuar, kundrejt pagesës së një tarife në përputhje me kreditet e lëndëve. Studenti ka të drejtë të frekuentojë edhe lëndët në të cilat nuk ka vlerësim kalues. Referuar rregullores mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, edhe në këtë dokument përshkruhen procedurat përkatëse dhe parashikimet për regjistrimin përfundimtar në program për studentët që regjistrohen me transferim/ mobilitetet. Studentët njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet “portalit të studentit”. Ata mund të tërheqin në cdo kohë vërtetimin me lëndët dhe rezultatet respektive, skurse edhe statusin e studentit në cdo lëndë.</p> <p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e studimeve dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimin e provimeve, realizimin e praktikave mësimore e profesionale, punimit përfundimtar, diplomimit, ndërprerjes dhe rifillimit të studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet fletpalosjeve e posterave që AI shpërndan në shkolla në takimet me maturantët. Po ashtu, në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si edhe pedagogë ku</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p>njihen me infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësitë, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e programit të studimit TLD, Informimi publik në website dhe në rrjete sociale; Fletpalosje, broshura, postera informativë, Takime në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Duke i'u referuar informacionit të dorëzuar, faqes së internetit të AI si dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon se AI ndjek procedurat në lidhje me transferimin e studimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi (Udhëzimi i MAS, nr. 17, datë 30.07.2019). Studentët informohen në lidhje me transferimin e studimeve, njohjen e kualifikimeve apo studimeve të pjesshme të realizuara në një institucion tjetër të arsimit të lartë. Kriteret e transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit sanksionohen qartë në rregulloren e AI. Po ashtu, institucioni ka vënë në dispozicion edhe tabelën e transferimeve të studentëve prej dhe nga programi i studimeve.</p> <p><i>[Ref. Procedurë e njohjes së krediteve, Tabela përmbledhese TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita e GVJ në institucion si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga AI, GVJ konstaton se përcaktimi i formës së vlerësimit të dijeve për lëndët specifike, bëhet nga pedagogu i lëndës si dhe pasqyrohet në syllabusin e lëndës. Syllabuset janë në dispozicion të studentëve në të gjitha format, si elektronikisht përmes faqes web të programit, ashtu edhe fizikisht në departament përmes sekretarisë mësimore. Studentët pohojnë se njihen me format e vlerësimit të njohurive teorike dhe praktike, nga komunikimi i drejtpërdrejtë me pedagogët, qysh në fillimin e procesit mësimor kur njihen me lëndën dhe në vazhdimësi.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë kriteret që duhet të plotësojë studenti për të shkuar drejt provimit përfundimtar, i cili në programin TLD kryhet duke dorëzuar një punim praktik të përgatitur gjatë një periudhe 2 javore. Në dosjen e programit përcaktohet në mënyrë të detajuar plani i realizimit të punimit, forma e kontrollit të tij, vlerësimi praktik dhe teorik i njohurive. Gjithashtu, studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike nga koordinatori i programit.</p> <p><i>[Ref. Udhezues për studentet i kryerjes së Praktikes Profesionale, Rregullore e Programit të Studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ konkludon se AI ofron informacione në mënyrë periodike të organizuara në paraqitje të ndryshme, si gjatë tureve informuese në shkolla të mesme mjekësore apo gjimnaze në Shqipëri, Kosovë Maqedoninë e Veriut dhe Serbi, ashtu edhe gjatë vizitave në ambjentet e AI.</p> <p>AI vendos në dispozicion të të interesuarve pedagogë e personel ndihmës akademik të tajnuar paraprakisht që informon të interesuarit mbi;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mundësitë që ofron në tregun shqiptar e botëror specializimi si teknik dentar,</li> <li>- infrastrukturën e institucionit,</li> <li>- leksionet dhe workshop-et që zhvillohen me lektore të kompanive europiane partnere të AI,</li> <li>- praktikat profesionale të cilat studentët i kryejnë në Shqipëri ose Gjermani.</li> </ul>

	[Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative, Takime në institucion]		
<b>Konkluzione</b>	<p>GVJ konkludon se rregullorja e programit TLD përmban me detaje të hollësishme procedurat e vlerësimit, kalimit në vitit akademik pasardhës etj, dhe ajo ju sqarohet studentëve drejtpërdrejt dhe gjendet në faqen web të AI. Në rregulloren e AI sanksionohen qartë kriteret për njohjen e studimeve të mëparshme të plota apo të pjesshme dhe është e publikuar gjithashtu në faqen web të AI.</p> <p>Studentët pohojnë se njihen në cdo fillim viti me rregulloret dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve praktike e teorike në secilën lëndë. Megjithëse institucioni i vogël, AI informon maturanët shumë hollësisht mbi çfarë ofron programi i studimit duke përdorur, turet, takimet online, vizitat në Akademi dhe është shumë aktive edhe me nxënësit e shkollave të mesme mjekësore në trojet shqiptare.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përmbushet plotësisht</b>.</p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Duke i'u referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes web të AI, si dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon se informacioni mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit i vihet në dispozicion studentëve nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- faqes web të programit: <a href="https://ivodent.edu.al/bachelor">https://ivodent.edu.al/bachelor</a>,</li> <li>- dosjes së programit TLD e disponueshme në bibliotekën e AI dhe sekretarinë mësimore,</li> <li>- në kontaktin gjatë javës së parë me personelin akademik.</li> </ul> <p>[Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative, Dosja e Programit TLD]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Institucioni informon studentët në mënyrë të hollësishme mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit dhe vendos në dispozicion të tyre informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit TLD. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për sa më sipër edhe nëpërmjet faqes web të programit. Informacioni i nevojshëm publikohet në format letër, guida, rregullore dhe fletpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për cdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme edhe përmes "portalit të studentit".</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)


Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

	<i>[Ref. Fletëpalosje, Broshura dhe Materiale informative, Website dhe rrjetet sociale]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	<p>Pas kqyrjes së dokumentacionit të grupit të vlerësimit të brendshëm dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan përpjekje të vazhdueshme të AI, për të studiuar tregun e punës dhe kërkesat e kriteret e tij.</p> <p>Studentët e diplomuar nga programi TLD në 5 vitet e fundit janë të punësuar 100% brenda dhe jashtë vendit sipas statistikave të dokumentuara nga AI dhe përbëjnë një burim të vazhdueshëm të informacionit mbi punësimin për studentët aktualë.</p> <p>Ai ruan marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi me shumë laboratorë në Shqipëri dhe në Gjermani, ku studentët e programit TLD kryejnë praktikat profesionale në vitin e tretë e më pas si rregull edhe punësohen. NJë praktikë e mirë është edhe marrveshja e bashkëpunimit e AI me një zyrë konsulence në Gjermani që ndihmon studentët e këtij programi në njohjen e diplomave dhe punësimin në Gjermani.</p> <p><i>[Ref. Punesimi TLD, Marrëveshje Ivodent BBW Gjermani]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes web të AI, si edhe vizitës në institucion, GVJ konkludon se studentëve nëpërmjet faqes së internetit, portalit të studentit, sekretarisë mësimore dhe personelit akademik, në mënyrë të vazhdueshme u vihet në dispozicion informacion i ë gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, numrin e lëndëve për çdo semestër, strukturën e vitit akademik, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon dhe ofron kushte cilësore dhe një fond të konsiderueshëm botimesh në hard copy dhe elektronikisht, shqip dhe anglisht kryesisht, por edhe në gjermanisht dhe greqisht. Stafi IT i AI ndihmon studentët me informacion mbi mënyrat dhe oraret e përdorimit të bibliotekës.</p> <p><i>[Ref. Raport Analitik 2021-2022, Raporti vjetor 2021-2022]</i></p>
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Nga takimi me studentët GVJ konstaton që materialet për lëndët që zhvillohen në këtë program studimi u mundësohen studentëve në momentin e regjistrimit të tyre, pajisen me një adresë e-maili të AI. Kjo u mundëson studentëve që nëpërmjet portalit të studentit të marrin të gjitha informacionet që dërgohen nga personeli akademik apo koordinatori i programit. AI ka një marrëveshje dhe përfiton nga shërbimet e platformës Google education, ku krijohen klasa virtuale (Google Classroom), në të cilat studentët kanë në dispozicion materiale didaktike. Në këtë mënyrë edhe pse studentët mund të jenë në distancë, ata mund të punojnë për thellimin e nohurive. Personeli akademik i AI ngarkon në kanalin zyrtar në YouTube video-demonstrime të orëve praktike duke ju mundësuar studentëve praktikë edhe në distancë.</p> <p><i>[Ref. Shërbimet digjitale studentore, Website dhe rrjetet sociale (1), Website Bachelor]</i></p>
<b>Konkluzione</b>	<i>GVJ konkludon se AI jep një informacion të hollësishëm mbi programin, objektivat e misionin e tij, rezultatet e pritshme në përfundim të secilës</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	<p><i>lëndë, pritshmëritë nga studentët nëpërmjet faqes web, dosjes së programit TLD, komunikimin në fillim të vitit akademik dhe broshurave e fletpalosjeve të printuara të disponueshme në ambientet e sekretarisë mësimore.</i></p> <p><i>AI vendos në dispozicion të studentëve informacione edhe nëpërmjet portalit të studentit apo Google Classroom duke mundësuar informacionin edhe në distancë.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga AI dhe në vizitën në sekretarinë mësimore, GVJ konkludon se AI disponon të dhënat për studentët, dosjet personale të studentëve si dhe regjistrat themeltarë, në të cilat pasqyrohen të dhënat personale të studentëve aktualë si dhe regjistrin e të diplomuarve. AI ka vënë gjithashtu në dispozicion edhe një listë të studentëve të diplomuar me kontaktet dhe laboratorët dentarë ku ata punojnë.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	AI krijon dhe ruan me kujdes dokumentacionin ku pasqyrohet çdo vit numri i studentëve të regjistruar në programet e studimit, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Informacioni disponohet nga sekretaria mësimore, i pasqyruar në regjistrin themeltar, që tregon regjistrimet, pezullimet apo dhe ndërprerjet e studimeve. Regjistri ruhet fizikisht dhe elektronikisht për një periudhë kohore të pacaktuar.  [Ref. Shembuj protokollesh laborator]
<b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga dokumentacioni i dërguar dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se AI menaxhon të dhënat statistikore të studentëve në mënyrë konfidenciale nëpërmjet programeve kompjuterike alternative, në mungesë të një sistemi të centralizuar të informacionit. Informacioni konfidencial mund të aksesohet përmes një kërkese me shkrim ose përmes portalit të studentit. Përmes tij studenti mund të shikojë vetëm ecurinë e tij në sistem dhe të marrë të dhëna për të.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e	GVJ konstaton se AI ka parashikuar në rregulloren e AI, rregulloren e sekretarisë dhe atë të NJSBC, kontrollimin e dokumentacionit të sekretarisë, arshivimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Dekanati i Fakultetit të Teknikave Dentare ushtron kontrolle periodike mbi saktësinë e informacionit, edhe duke monitoruar procesin e prodhimit të kartave të studentit pranë Bashkisë Tiranë.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.							
<b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Duke ju referuar vizitës në institucion, u konstatua nga GVB se departamenti i protetikës kryen vlerësime dhe raportime të drejtpërdrejta analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Informacioni transmetohet vit pas viti deri në diplomimin e studentëve dhe ruhet në sekretarinë mësimore. Punësimet e studentëve pas diplomimit përbëjnë statistika me vlerë për AI që ruhen dhe i janë vënë në dispozicion edhe grupit të vlerësimit në formë tabelare.  [Ref. Takim Ivodent - BBW - Përfaqësues i Industrisë IHK]						
<b>Konkluzione</b>	Në rastin e programit TLD, bazuar në arsyetimin e mbështetur në dokumentacion, AI merr, ruan dhe menaxhon të dhënat e studentëve në mënyrë të rregullt duke i ruajtur ato në tre regjistrat themeltar, të arritjeve akademike dhe të diplomimit. Dokumentacioni i mësipërm është i ruajtur edhe në formë elektronike dhe bazuar mbi të sekretaria mësimore i menaxhon të dhënat në formën e tabelave statistikore, lehtësisht të aksesueshme dhe të kontrollueshme nga Dekanati i Fakultetit. Numri i vogël i studentëve në këtë program studimi mundëson raportime të shpeshta e të drejtpërdrejta në departament mbi cilësinë në hyrje e në dalje të studentëve, si edhe punësimin e tyre mbi bazë individuale, e cila u evidentua edhe në takimet në institucion me studentët dhe personelin. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b> .						
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

<b>Standardi V.5</b> Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se, AI ka parashikuar në organizimin dhe funksionimin e tij pjesëmarrjen e studentëve. Në Statutin e AI është e përcaktuar që një nga shtatë antarët e tij të jetë student. Ndër strukturat kryesore përmendim: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli studentor - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.</li> <li>- Senati Akademik - ka një përfaqësues të studentëve.</li> <li>- Komisioni i Etikës - një antar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.</li> <li>- Mbledhjet e Departamentit janë të hapura për studentët</li> </ul> [Ref. Rregullore Këshilli Studentor, Takime në institucion]

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në Statutin e IAL është përcaktuar që një prej anëtarëve të NJSBC-së është anëtar i Këshillit të Studentëve. Po kështu edhe në GVB në kuadër të procesit të akreditimit njëri prej antarëve është student. Departamenti i Protetikës i zhvillon mbledhjet të hapura për studentët e pedagogët për të mbledhur mendimet e sugjerimet dhe për të kontrolluar mbarëvajtjen e studimeve apo problematikat nga studentët. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit TLD është pjesë e GVB të ngritur me urdhër të Rektorit të AI, në kuadër të hartimit të këtij raporti.</p> <p><i>[Ref. Statuti i Akademisë Ivodent]</i></p>		
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon siç u shprehëm edhe më sipër, në AI garantohej përfshirja e studentëve në procese të ndryshme vendimmarrëse apo të tjera, gjë që realizohet edhe në rastin e rishikimit për përmirësim të programit.</p> <p><i>[Referuar RVB dhe vizitës në institucion]</i></p>		
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, GVJ konkludon se personeli akademik e ka në vëmendje barazinë dhe meritokracinë e studentit në vlerësim dhe në mënyrë hierarkike shqyrtohet çdo ankimim. Sekretimi i provimeve me shkrim, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm që parashikohet në rregulloren e programit, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>GVJ konkludon se për programin TLD, studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Senatën Akademik të AI. Studentët kanë organin e tyre aktiv, Këshillin studentor për të diskutuar e përcjellë më tej çdo problematikë. Komunikimi me autoritetet dhe organet drejtuese të AI është i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë edhe për shkak të numrit të kufizuar të studentëve. Mendimi i studentëve mbi përmirësimet e mundshme në procesin e mësimdhënies/nxënies dhe programit të studimit tërhiqet periodikisht përmes anketimeve.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

**Standardi V.6**


Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të</p>	<p>Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedës në institucion, GVJ konkludon se në Akademinë Ivodent funksionon Zyra e</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Sekretarisë Mësimore dhe Shërbimeve ndaj Studentit. Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike e studentore. Koordinator i programit TLD është gjithashtu në shërbim të informimit të studentëve.  <i>[Ref. Rregullore sekretarise mesimore, Organigrama dhe Personeli 2022-2023]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe bisedave në takimet në institucion vihet re se veprimtaria e Zyrës së Shërbimeve ndaj Studentit orientohet drejt informimit të studentëve dhe këshillimit të tyre në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara, avantazhet që secili prej tyre paraqet, mundësitë e punësimit në të ardhmen, etj.  <i>[Ref. RVB, takimet në institucion]</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, Zyra e Shërbimeve ndaj Studentit mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në laboratorët dentarë brenda e jashtë vendit me të cilat AI ka bashkëpunime, dhe orientimin në tregun e punës. Detyrë e Zyrës së Shërbimeve ndaj studentit është edhe që të ndërmjetësojë dhe të japë informacion në lidhje me ofertat e punësimit nga laboratorët dentarë, trajnime etj.  <i>[Ref. Statistika MAS 20-21, Statistika MAS 21-22, Shërbimet e mbështetjes studentore]</i>
<b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, RVB, si dhe vizitës në institucion, GVJ evidenton se Zyra e Shërbimeve ndaj Studentit ndjek studentët pas diplomimit, mbledh dhe përpunon të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimeve dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse. Kjo zyrë mban lidhje të vazhdueshme me laboratorë dentarë brenda e jashtë vendit, ku punojnë ish-studentë të programit TLD dhe ndjek kështu zhvillimin profesional të studentëve alumni.  <i>[Ref. Punësimi TLD]</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Zyra e mbështetjes ndaj studentit në AI ofron shërbime për studentët e programit TLD që në hyrjen e tyre e deri pas diplomimit. Studentët informohen saktë për zgjedhjen e programit të studimit në teknika dentare në momentin e regjistrimit. Si praktikë e mirë identifikohet bashkëpunimi me laboratorë në Gjermani ku kryhen praktika profesionale të studentëve në semestrin e jashtë të studimeve. AI bashkëpunon ngushtë me shumë laboratorë dentarë ku janë punësuar ose drejtojnë studentët alumni të AI, duke ndjekur kështu ecurinë e tyre profesionale dhe duke informuar drejt studentët aktualë për mundësitë aktuale që ofron tregu dentar. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)





## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion GVJ konkludon se AI ka zhvilluar dhe nxit përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe disponon manuale e shembuj të praktikave të mira të përdorimit për të udhëzuar personelin dhe studentët në përdorimin e tyre. AI përdor shërbimet e Google Education ku prezantohet materiali didaktik multimedial dhe mundësohet komunikimi i vazhdueshëm i personelit akademik me studentët. Teknologjia e nevojshme është e disponueshme në institucion.</p> <p><i>[Ref. Udhëzues per mesimdhënie online (Manual i përdorimit te GOOGLE Classroom), Manual përdorimi paisjes laboratorike, vizita në institucion]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ arrin në përfundimin se AI ka një politikë të vlerësimit të performancës së personelit akademik e atij ndihmës, bazuar në formularë të vlerësimit nga eprori dhe të vetëvlerësimit. Gjithashtu, NJSBC anketon rregullisht studentët dhe personelin mësimdhënës akademik e ndihmës.</p> <p>AI ka marrveshje edhe me një institucion të jashtëm të verifikimit të cilësisë IQE, i cili është vazhdimisht aktiv me anketa e pyetësorë. Rezultatet e anketave përpunohen statistikiisht dhe ju vihen në dispozicion departamentit dhe autoriteteve drejtuese.</p> <p><i>Konstatojmë që mungon një udhëzues i posaçëm në formën e një politike për monitorimin e Cilësisë, pavarësisht ekzistencës së dokumentave që e zëvendësojnë atë pjesërisht.</i></p> <p><i>[Ref. Udhëzues per mesimdhënie online (Manual i përdorimit te GOOGLE Classroom), Shembull Ankete studentore, Marrëveshje Ivodent - IQE, Rezultatet e pyetesorit te studenteve AI-IQE, PSV Mbledhje personeli akademik për diskutimin e analizës së cilësisë dhe aplikimit për programin e ri Master Shkencor]</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>GVJ konstaton se NJSBC e AI zhvillon anketime të studentëve në vazhdimësi. Anketat kryhen me objektiv evidentimin me detaje të problematikave që mund të shfaqen në mësimdhënie dhe vlerësim.</p> <p>Nëpërmjet pjesëmarrjes së studentëve në mbledhje të hapura në departament dhe komisionit të Etikës garantoher plotësisht edhe gjurmimi i cdo pakënaqësie eventuale.</p> <p><i>[Ref. Shembull Ankete studentore]</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe nga takimet në AI, GVJ vëren se departamenti i protetikës i bën publike rezultatet e anketimeve të kryera me studentët e personelin akademik të programit TLD duke i diskutuar në</p>

E-mail: info@ascal.al

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	mbledhje të hapura të departamentit. Analiza i bëhet e njohur edhe dekanatit.  [Ref. Raport NJSBC mbi Anketat]		
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ konkludon se programi TLD ka kaluar në disa porcese akreditimi/riorganizimi në tre vitet e fundit që me rekomandimet e tyre kanë ndihmuar në konsolidimin e programit dhe mekanizmave të sigurimit të brendshëm të cilësisë. GVJ konstatoi disa praktika të mira si standardizimi i vlerësimit të testeve me punime praktike të protezave dentare apo dorëzimi i protokolleve të shkruara të punës së realizuar nga studenti në laborator.  [Ref. Shembuj protokollesh laborator, Fletë vlerësimi praktike]		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon se në rastin e programit TLD, AI ka një politikë të vlerësimit të performancës së personelit akademik dhe atij ndihmës, nëpërmjet plotësimit të formularëve të vlerësimit nga eprori dhe vetëvlerësimit. Zyra e NJSBC në AI është aktive me anketimet, përpunimin statistikor të rezultateve dhe bërjen e tyre publike. Gjithashtu AI ka marrveshje me IQE për të realizuar edhe një vlerësim të jashtëm të cilësisë së programit. Rezultatet e anketimeve diskutohen në mbledhjet e departamentit të protetikës, që zhvillohen të hapura edhe për studentët. Evidentimi i mangësive të vërejtura në procesin e mësimdhënies dhe vlerësimit reflektohet nëpërmjet procesit të përmirësimit sic dokumentohet nga AI në rastin e testeve të standardizuara të punimeve praktike dhe plotësimit të protokolleve të punimeve dentare në laborator. Mungon një udhëzues i posaçëm në formën e një politike për monitorimin e Cilësisë, pavarësisht ekzistencës së dokumentave që e zëvendësojnë pjesërisht.  Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
		X	

### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	GVJ konkludon se në AI ekzistojnë dhe janë aktive strukturat dhe procedurat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me nenin 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Zyra e NJSBC është pjesë e organigramës së AI e parashikuar në Statut dhe harton procedura të sigurimit të Cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë. AI kryen vlerësim periodik të performancës së personelit akademik e ndihmës, si përsa i përket mësimdhënies, ashtu edhe kërkimit shkencor, angazhimit me studentët etj, duke u bazuar në tregues të marrë nga standardi ISO 21001:2018 për menaxhimin e institucioneve arsimore.

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al

	<i>[Ref. Vlerësimi i performancës, Statuti i Akademisë Ivodent]</i>		
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vizitën në AI, GVJ konstaton se AI ka funksional një sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ku qendrore është Zyra e NJSBC, aktiviteti i së cilës përcaktohet në Statutin dhe Rregulloren e AI. Gjithashtu kryhet edhe një kontroll i Cilësisë nëpërmjet një bashkëpunëtori të jashtëm të AI si Institute for Quality in Education (IQE).		
	<i>[Ref. Marrëveshje Ivodent - IQE]</i>		
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Nga shqyrtimi i dosjes së programit TLD të dorëzuar nga GVB, konstatoam se programi TLD ka kaluar një proces akreditimi të parë në vitin 2013 dhe një të dytë në vitin 2020. Në vitin 2021 ka kaluar një proces të riorganizimit në mbi 20% dhe është hapur me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit pas një kontrolli nga ekspertë të fushës. Për këtë arsye ky proces akreditimi konsiderohet edhe si akreditim për herë të parë. Në këtë mënyrë cilësia e programit është e vlerësuar maksimalisht dy herë më parë nga ekspertë të jashtëm të MASR. Ky vlerësim bëhet konform Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, duke përdorur instrumentat e duhur, ashtu si edhe anketimet që kryen NJSBC brenda AI. Vlerësimi i jashtëm i Cilësisë është kryer edhe nga IQE.		
	<i>[Ref. Vendim i Bordit të Akreditimit për akreditimin Institucional, Urdher MAS per riorganizimin e Bachelor TLD]</i>		
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	GVJ konkludon bazuar në dokumentacionin e dërguar dhe takimet në institucion se AI përdor tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nga personeli akademik e ndihmës që jepen në formatet e vlerësimit nga eprori dhe vetvlerësimit. NJSBC bashkëpunon me përgjegjesin e departamentit dhe Dekanin për përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve, me qëllim pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe mangësive.		
	<i>[Ref. Vlerësimi i performancës, Raporti vjetor 2021-2022]</i>		
<b>Konkluzione</b>	GVJ konkludon bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga AI, prej ku vecon se për shkak të numrit të reduktuar të personelit, AI është ende në fazën e plotësimit me dokumenta të menaxhimit të cilësisë konform standardit ISO 21001:2018. Zyra e NJSBC pranë AI vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të tre programet e studimit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti statistikor dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse si edhe titullarit të lëndës dhe përgjegjësit të departamentit. Institucioni vlerëson performancën e personelit akademik dhe ndihmës në mësimdhënie e kërkim shkencor duke përdorur tregues të qartë e të matshëm nga standardi ISO 21001 "Për menaxhimin e institucioneve arsimore". Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b> .		
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

**Standardi VI.3**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në funksion të garantimit të cilësisë rol të rëndësishëm kanë departamentet si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku titullarët e lëndëve/ koordinatori i programit kanë detyra specifike që lidhen me çështje të rishikimit të kurrikulës, syllabuseve dhe literaturës në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe standardet dhe Sstrategjinë Institucionale të AI.</p> <p>Departamenti ka vepruar sipas një plani veprimi të krijuar mbi bazën e gjetjeve të NJSBC, kërkesave aktuale të tregut dentar dhe rekomandimeve në vendimin e akreditimit të programit në 2020 për përmirësimin e kurrikulës së TLD që ka sjellë edhe riorganizimin e programit në vitin 2021.</p> <p><i>[Ref. Rregullore e NJSBC, Rregullore e programit të studimit TLD, Propozim për riorganizimin e programit të studimit TLD]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. NJSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë, monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive.</p> <p><i>[Ref. Raport mbi plotësimin e rekomandimeve]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo</p>	<p>Sipas takimit me përfaqësues të institucionit metodat e përdorura përfshijnë instrumenta për mbarëvajtjen e mësimdhënies, cilësinë e literaturës, proceset didaktike të përdorura dhe pjesëmarrjet në konferenca.</p> <p>Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies realizohen pyetsorë, ku studentët japin mendimin e tyre në lidhje me zhvillimin e komponentëve të modulit, përgatitjen e pedagogut, sjelljen e tij etj. Studentët shprehin mendimin e tyre në sondazhe e anketa të organizuara nga NJSBC apo IQE.</p> <p>Instrumentet kryesore për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetsorëve online, mbledhjet e hapura të departamenteve etj.</p> <p>AI në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Teste të standardizuara të kontrollit të teorisë dhe punimeve praktike dentare</li> <li>- dëgjime në auditor,</li> <li>- vlerësimi me pikë</li> </ul>



<p>kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; praktikë,</li> <li>- vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët,</li> <li>- vlerësimi i protokolleve të dokumentimit të realizimit të punimeve të ndryshme të protezave dentare</li> <li>- vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</li> </ul> <p>Për personelin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor zhvillohen edhe vizita nga eprori (Përgjegjësi/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces reflektohet në vlerësimin nga eprori në përfundim të vitit akademik.</p> <p><i>[Ref. Formulari i vlerësimit të performancës së personelit akademik]</i></p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Nga takimet në institucion dhe dokumentat e vëna në dispozicion GVJ konstaton se AI përdor metoda e instrumente të tërthorta për vlerësimin e realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit TLD duke u mbështetur në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mendimin dhe vlerësimin mbi përgatitjen e studentëve të programit TLD nga lektorë të qendrave të edukimit dentar si “Ivoclar Academy” apo “3Shape Academy” me të cilët studentët kryejnë workshop-e 2-3 ditore. Në përfundimin me sukses studentët vlerësohen prej tyre. Kjo praktikë e mirë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së studentëve ka traditë të gjatë në AI.</li> <li>- Vlerësimin e studentëve nga drejtues të laboratorëve dentarë bashkëpunorë të AI gjatë kryerjes së praktikave profesionale</li> <li>- Intervistat me studentët alumni mbi eksperiencat e tyre në vendin e punësimit</li> </ul> <p>Rezultatet e tyre ju vihen në dispozicion drejtuesve të njëjësive bazë e kryesore dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së cdo personeli akademik e ndihmës në përfundim të vitit akademik.</p> <p><i>[Ref. Certifikatë trajnimi për studentë, alumni e profesionistë të fushës, Dëshmi javore e praktikës profesionale]</i></p>						
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Bazuar në gjetjet e evidentuara në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga AI dhe të konfirmuara edhe në takimet në institucion, Departamenti i Protetikës dhe NJSBC monitorojnë realizimin dhe mbarëvajtjen cilësore të programit TLD duke përdorur raporte të përvitshme që janë përgatitur në kuadër të akreditimit dhe riorganizimit të programit TLD. Vlerësimi me metoda direkte kryhet saktë duke përdorur llojshmëri të bollshme të tyre.</i></p> <p><i>Si një praktikë e mirë e vlerësimit me metoda të tërthorta vlen të përmendet testimi praktik i studentëve nëpërmjet workshop-eve me trajnues nga qendra të edukimit dentar në europë, të cilët vlerësojnë studentët thujse në cdo lloj preteze dentare.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>						
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 1615 762 1688">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="762 1615 1018 1688">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1018 1615 1257 1688">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1688 762 1727"></td> <td data-bbox="762 1688 1018 1727"></td> <td data-bbox="1018 1688 1257 1727">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**Standardi VI.4**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Akademia Ivodent ka marrveshje bashkëpunimi me shumë laboratorë dentarë në Shqipëri e Gjermani ku studentët kryejnë praktikat profesionale dhe planifikon të lidhë marrveshje të reja në vazhdim. Gjithashtu, ka aplikuar në projektin RCF të financuar nga qeveria gjermane për digjitalizimin e teknikave dentare së bashku me dy laboratorë dentarë në Shqipëri. Përfshirja në AI e personelit ndihmës-akademik të mirnjohur në Shqipëri për cilësinë e punimeve në laboratorin e tij dentar, mundëson përfshirjen e një grupi jo të vogël specialistësh në AI që influencojnë në politikat dhe realizimin e mbarëvajtjen me cilësi të programit TLD.</p> <p><i>[Ref. Aplikimi RCF]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Studentët përfshihen në vlerësim përmes anketimit dhe mbledhjeve të hapura të departamentit. Përfshihen edhe në vendimmarrje përmes përfaqësuesit të tyre në Senatit Akademik, si pjesë e qeverisjes së AI, përfaqësisë në Komisionin e Etikës dhe Këshillit Studentor.</p> <p><i>[Ref. Statuti i AI, takimet në institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, mund të pohojmë një gjithpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme të departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit.</p> <p><i>[Ref. Takimet në Institucion]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Fakulteti i Teknikave Dentare është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi e pabarazie të gjithë palëve të përfshira në këtë proces. Procesi i vlerësimit zhvillohet duke respektuar Kodin e Etikës dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik e studentëve. Për të siguruar përfshirjen e plotë të stafit në përmirësimin e cilësisë së programit, AI ka krijuar grupet e punës që sigurojnë këtë të fundit në drejtim të kurrikulës, veprimtarisë shkencore dhe vëmendjes ndaj studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përveç antarëve të personelit akademik e studentëve, Akademia Ivodent ka ekspertë të jashtëm cilësie si antarë të Bordit të Administrimit. Lektorë të qendrave të edukimit dentar si “Ivoclar Academy“ dhe “3Shape Academy” janë vlerësues të përvitshëm të cilësisë së programit TLD. Përveç vlerësimit të brendshëm, element tjetër i sigurimit të cilësisë është edhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet raporteve të vlerësimit, ku pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë.</p> <p><i>[Ref. Organigrama e AI]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>NJSBC kryen vlerësime të cilësisë në programin TLD, duke përfshirë studentët dhe stafin. Rezultatet e anketimeve dhe pyetësorëve përpunohen</i></p>

	dhe ju vihen në dispozicion drejtuesve të njësisë bazë e kryesore në AI si dhe bëhen publike në faqen web të saj. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard <b>përbushet plotësisht</b> .		
<b>Shkalla e përbushjes së standardeve</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Informacionet në lidhje me politikat dhe praktikatat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në AI janë të aksesueshme lehtësisht online nga personeli akademik, ndihmës dhe studentët. GVB konkludon se veprimtaria e NJSBC zhvillohet kryesisht në kuadrin e pyetsorëve me studentët prej dy herë në vit, ku rezultatet ju vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit por bëhen transparente edhe për personelin e studentët përmes mbledhjeve të hapura në departament.  [Ref. Rezultatet e pyetsorit të studentëve]
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej tyre konstatohet se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. Rezultatet e vlerësimit NJSBC i bëhen publike në formë statistikore e anonime.  [Ref. Takime me personelin akademik dhe me NJSBC]
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në takimet në institucion, GVJ konkludon se dobësitë a mangësitë e vërejtura të cilësisë së programit TLD adresohen nga AI dhe përmirësohen përmes një plani masash që i propozohet autoriteteve drejtuese nga NJSBC dhe reflektohen në vendimmarrje konkrete.  [Ref. Raport mbi plotësimin e rekomandimeve, Raport i NJSBC mbi anketat]
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga AI, GVJ konkludon se AI siguron komunikim dhe bashkëveprim brenda dhe jashtë institucionit për të implementuar masat e propozuara në favor të përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit. Analiza periodike e ecurisë së monitorimit dhe përmirësimit është pjesë e Raportit vjetor që krijon AI. Gjithashtu AI implementon rekomandimet e ardhura nga MAS për menaxhimin e cilësisë në institucion.  [Ref. Raporte vjetore të AI, Takime në institucion]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin	Nga dokumentacioni i dorëzuar dhe takimet në institucion GVJ konkludon se AI vepron për krijimin e kulturës institucionale të cilësisë nëpërmjet:


Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>- trajnimeve periodike të personelit akademik e ndihmës për përmirësimin e mësimdhënies dhe njohjen me aktet e brendshme rregullatore të sigurimit të cilësisë.</p> <p>- takimeve me studentët dhe vlerësimin të mendimit të shprehur prej tyre dhe këshillit studentor</p> <p><i>[Ref. Rregullore e NJSBC, Takime në institucion]</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Për programin e studimit veprimtaria e menaxhimit të cilësisë në AI është transparente si për drejtuesit e institucionit, pedagogët edhe studentët.</i></p> <p><i>Në menaxhimin e cilësisë bazuar në gjetjet planifikohen dhe implementohen masat e duhura duke i raportuar ato në formë dokumentash institucionale, duke ruajtur etikën dhe të dhënat personale.</i></p> <p><i>Institucioni ka nisur të implementojë politika në zbatim të standardit ISO 21001:2018 të cilat duhet të zhvillohen edhe në drejtimin e dokumentave institucionale qëndihmojnë menaxhimin e cilësisë në programin TLD.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	






**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknikë e Lartë Dentare” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Ivodont “**

**Fikat e forta dhe afirmime:**

1. Program që përmban njohuri të avancuara të teknikave dentare në krahasim me programet e ngjashme në vend dhe rajon si suprastrukturat mbi implante apo protezimin estetik përmes fasetave.
2. Laboratorë të pajisur me teknologjinë bashkëkohore dentare ku përdoren materiale dhe instrumenta cilësore të prodhuesve prestigjiozë zviceranë, gjermanë e italianë.
3. Programi parashikon praktika profesionale në Shqipëri dhe Gjermani nëpërmjet bashkëpunimeve të institucionalizuara dhe dokumentuara me laboratorë e qendra dentare, të cilat ndihmojnë në punësimin e menjëhershëm të studentëve.
4. Trajnime të avancuara disa herë në vit për studentët nga trajnues të qendrave prestigjiozë europiane të edukimit në teknologjinë dentare si “Ivoclar Academy”, “3Shape Academy” etj.
5. Personel akademik e ndihmës akademik me eksperiencë të gjatë profesionale në fushën e prodhimit të protezave dentare dhe aparateve ortodontike si dhe angazhim i studentëve në kërkimin shkencor që lidhet me fushën e materialeve dentare.


**Pika të dobëta.**

1. Pavarësisht disponibilitetit të literaturës së nevojshme për programin e studimit TLD në format elektronik, duhet të rritet numri i teksteve në hard-copy në fushën e teknologjisë dentare në dispozicion të studentëve. [Standarti IV.3, Kriteri 4 ]
2. Institucioni haset në vështirësi financiare në diversifikimin e burimeve të financimit dhe mbështetet kryesisht në tarifën e studimit. [Standarti IV.5, Kriteri 5]
3. Mungesa e një udhëzuesi të posaçëm në formën e një politike për monitorimin e Cilësisë, pavarësisht ekzistencës së dokumentave që e zëvendësojnë pjesërisht. [Standardi VI.1, kriteri 2]

**Rekomandime:**

1. Rekomandojmë që institucioni të ofrojë shërbime për të tretë duke shfrytëzuar kapacitetet infrastrukture dhe njerëzore të AI.
2. Hapjen e programeve të ciklit të tretë apo ofrimin e doktoraturave si “joint degree” në fushat ku AI ka ekspertizë si ajo e biomaterialeve dhe teknikave digjitale, që do përmirësonin përfshirjen e studentëve dhe personelit në kërkimin shkencor të aplikuar dhe do rrisnin mobilitetin.
3. Rritjen e numrit të studentëve në programin TLD.

4. Te hartohet nje udhezues i posacem ne formen e nje politike per monitorimin e Cilësisë.
5. Rritjen e bashkëpunimeve me laboratorë dentarë në Europë me qëllim rritjen e cilësisës së programit dhe numrit të praktikave profesionale atje.



**Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Higher Dental Technique" offered by the Institution of Higher Education "Ivodont Academy"**

**Strengths and Affirmations:**


1. Program that contains advanced knowledge of dental techniques compared to similar programs in the country and region such as superstructures on implants or aesthetic prosthetics through veneers.
2. Laboratories equipped with modern dental technology where quality materials and instruments of prestigious Swiss, German and Italian manufacturers are used.
3. The program envisages professional practices in Albania and Germany through institutionalized and documented collaborations with laboratories and dental centers, which help in the immediate employment of students.
4. Advanced training several times a year for students from trainers of prestigious European centers of education in dental technology such as "Ivoclar Academy", "3Shape Academy" etc.
5. Academic staff and academic assistance with long professional experience in the field of dental prostheses and orthodontic appliances production as well as student engagement in scientific research related to the field of dental materials.

**Weak points:**

1. Despite the availability of the necessary literature for the TLD study program in electronic format, the number of hard-copy texts in the field of dental technology available to students should be increased. [Standard IV.3]
2. The institution faces financial difficulties in diversifying funding sources and relies mainly on study fees. [Standard i IV.5]
3. The lack of a special guideline in the form of a Quality monitoring policy, despite the existence of documents that partially replace it. [Standard VI.1]

**Recommendations:**

1. We recommend that the institution provides services to third parties by utilizing the infrastructural and human capacities of AI.
2. The opening of third-cycle programs or the offering of doctorates as "joint degrees" in areas where AI has expertise such as biomaterials and digital techniques, which would improve the involvement of students and staff in applied scientific research and increase mobility.
3. Increasing the number of students in the TLD program.
4. To draw up a special guide in the form of a policy for Quality monitoring
5. Increasing cooperation with dental laboratories in Europe in order to increase the quality of the program and the number of professional practices there.



**Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

